



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Statistika
Zyrtare”**

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dafina XHAKO

Dr. Dolantina HYKA

Dhjetor / 2025

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

1

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” ofruar nga Universiteti i Tiranës.

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 687, datë 15.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 351, datë 25.11.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për here të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 11 PAE / 6 PAK 2023-2024 3 PAE / 2 PAK 2024-2025 10 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 13 studentë 2023-2024 0 studentë 2024-2025 15 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” (MSHSZ) ofrohet nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ), dhe u hap në vitin akademik 2018-2019 në kuadër të iniciativës evropiane European Master in Official Statistics (EMOS). Ky program është konceptuar për të përgatitur specialistë të kualifikuar në fushën e statistikave zyrtare, të aftë të kontribuojnë në prodhimin, analizën dhe përdorimin e të dhënave statistikore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi ka një kohëzgjatje 2 vjet (4 semestra) dhe është i strukturuar me 120 ECTS, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me Komizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF, Niveli 7). Studimet zhvillohen me kohë të plotë dhe në gjuhën shqipe, ndërsa pjesë e moduleve përfshijnë literaturë dhe referenca në gjuhë të huaj. Programi kombinon përgatitjen teorike me formimin praktik, përfshirë praktika profesionale në Institutin e Statistikave (INSTAT) dhe institucione të tjera publike dhe private, duke garantuar përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Stafi akademik përbëhet nga 18 pedagogë (profesorë, profesorë të asociuar, lektorë me titull PhD dhe MSc), të cilët mbulojnë një gamë të gjerë disiplinash në statistika, ekonomi, informatikë dhe fusha të lidhura. Stafi ka eksperiencë kërkimore dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, duke i ofruar studentëve një përvojë të pasuruar akademike dhe praktike. Programi mbështetet në një rrjet të gjerë bashkëpunimesh ndërkombëtare, përfshirë universitete partnere si NTNU (Norvegji), Universiteti i Torinos, Linnaeus University, TU Wien, Koblanz-Landau (Gjermani) dhe agjencitë statistikore të vendeve të BE-së. Këto bashkëpunime ofrojnë mundësi për mobilitet studentor dhe akademik, si dhe për përfshirjen në projekte kërkimore të financuara nga BE. Nga pikëpamja e përfitimeve për studentët, programi ofron përgatitje të avancuar në analizën e të dhënave, modelimin statistik, metodologjinë e kërkimeve dhe përdorimin e software-ve statistikore, duke i aftësuar ata të punësohen në institucione publike, banka, agjenci ndërkombëtare, organizata kërkimore dhe sektorin privat. Prosesi i sigurimit të cilësisë zbatohet në përputhje me kërkesat e ASCAL dhe me Standardet Evropiane ESG, përmes raporteve të brendshme të cilësisë, feedback-ut nga studentët dhe mekanizmave të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës. Në përfundim, MSHSZ është një program me rëndësi strategjike për Shqipërinë, pasi kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve të prodhimit dhe përdorimit të statistikave zyrtare, në përputhje me procesin e integritimit evropian dhe kërkesat e tregut të punës.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i Vlerësimit të Jashtëm për programin Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” (MSHSZ) u zhvillua në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe me standardet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), duke ndjekur parimet e Standardit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ESG). Ky proces kishte për qëllim të verifikonte përputhshmërinë e programit me misionin e institucionit, ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, si dhe me nevojat e tregut të punës dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i përbërë nga ekspertët **Prof. Asoc. Dafina Xhako** dhe **Dr. Dolantina Hyka** dhe Koordinatorin Teknik i ASCAL Msc. Arbri Ndreka, të cilët analizuan dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, duke përfshirë Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), evidencat mbështetëse (rregullore, syllabuse, plane mësimore, procesverbale, marrëveshje bashkëpunimi, raporte vjetore), si dhe statistikat mbi studentët dhe stafin akademik.

Procesi u realizua në disa faza duke filluar me analizën paraprake të dokumentacionit, ku GVJ shqyrtoi RVB dhe evidencat për të identifikuar pikat e forta dhe fushat që kërkojnë përmirësim. Më tej ky proces u shoqërua me vizita në Institucion, ku përfshiu takime me drejtuesit e institucionit, stafin akademik të përfshirë në program, studentë aktualë dhe të diplomuar, si dhe përfaqësues të punëdhënësve (INSTAT, Banka e Shqipërisë, agjenci statistikore). Vizita shërbeu për të verifikuar të dhënat e raportuara dhe për të marrë një panoramë të qartë mbi funksionimin e programit. GVJ realizoi intervista të strukturuar me grupet e interesit për të mbledhur mendime mbi cilësinë e mësimdhënies, mbështetjen e studentëve, lidhjet me tregun e punës dhe proceset e sigurimit të cilësisë. Programi u krahasua me programe të ngjashme në nivel evropian (EMOS), për të vlerësuar përputhjen në përmbajtje, ngarkesë akademike dhe rezultate të të nxënit.

Pas këtyre fazave, GVJ hartoi një raport analitik me gjetjet kryesore për çdo standard, duke evidentuar pikat e forta (stafi akademik i kualifikuar, bashkëpunimet ndërkombëtare, përputhja me strategjitë kombëtare) dhe sfidat (nevoja për më shumë literaturë të specializuar, pajisje IT, struktura më të zgjeruara për praktikat profesionale).

Procesi u zhvillua mbi parimet e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe bazimit në evidenca, duke garantuar që përfundimet dhe rekomandimet të jenë të verifikueshme, të argumentuara dhe të dobishme për përmirësimin e programit në të ardhmen.

IAL është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 17.11.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.1381/6 Prot, datë 17.11.2025. IAL njofton në ASCAL më datë 04.12.2025, “Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Statistikë Zyrtare (MSHSZ), i ofruar nga Universiteti i Tiranës, rezulton të jetë në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ruajtjen dhe promovimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Struktura dhe përmbajtja e programit janë ndërtuar në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës dhe janë koherentë me objektivat strategjike të përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit për periudhën 2023-2028. Në aspektin funksional, programi synon të përgatisë profesionistë të kualifikuar në fushën e statistikave zyrtare, duke mbështetur kështu një prej prioriteteve të deklaruara të politikave shtetërore, përkatësisht zhvillimin e kapaciteteve statistikore kombëtare dhe përafrimin me standardet evropiane të Eurostat-it. Ky orientim përforcon transparencën, besueshmërinë dhe përdorimin efektiv të të dhënave zyrtare në proceset e hartimit të politikave publike. Gjithashtu, nga shqyrtimi i përmbajtjes mësimore rezulton se programi ruan dhe pasqyron elementë të kulturës akademike dhe identitetit kombëtar, ndër të cilët veçohet moduli "Statistikat në politikëbërjen kombëtare", i cili trajton kontekstin shqiptar të përdorimit të statistikave në funksion të mirëqeverisjes dhe zhvillimit institucional. Kjo dëshmon për një integrim të qëllimshëm dhe të qëndrueshëm të dimensionit kombëtar në filozofinë dhe përmbajtjen e programit.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.1: Statuti i UT; Ev. 1.3: Strategjia e Zhvillimit 2023-2028; Ev. 03: Rregullore e Programit</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është hartuar dhe strukturuar në përputhje të plotë me misionin, vizionin dhe fushën e veprimtarisë së Universitetit të Tiranës. Në dokumentet themelore të institucionit, përfshirë Statutin dhe Strategjinë e Zhvillimit, theksohet roli qendror i studentit në procesin mësimor, si dhe orientimi drejt zhvillimit të dijeve përmes kërkimit shkencor dhe formimit të

	<p>specialistëve të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe institucional të vendit. Programi i studimit pasqyron këtë mision institucional duke ndërthurur përmbajtje teorike dhe praktike që synojnë zhvillimin e kapaciteteve akademike, profesionale dhe personale të studentëve në fushën e statistikave zyrtare. Struktura e kurrikulës dhe rezultatet e të nxënësve janë ndërtuar mbi parimin e formimit të një profili specialisti të përputhshëm me nevojat e tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar, në përputhje me objektivat e misionit të institucionit. Programi është konceptuar duke pasur parasysh orientimin strategjik të Universitetit të Tiranës drejt ndërkombëtarizimit. Kjo dëshkohet nga përfshirja në program e moduleve të harmonizuara me kornizën EMOS (European Master in Official Statistics) dhe nga bashkëpunimet me universitete partnere në Bashkimin Evropian, të cilat ndihmojnë në shkëmbimin akademik dhe në ndërtimin e përvojës ndërkombëtare për stafin dhe studentët.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.1: Statuti UT; Ev. 03: Rregullore e Programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është konceptuar dhe ofruar në përputhje të plotë me dispozitat e Statutit dhe Rregullores së brendshme të Universitetit të Tiranës, si dhe në harmoni me strategjinë institucionale të zhvillimit. Gjithashtu, ai respekton kuadrin më të gjerë të dokumenteve kombëtare që rregullojnë arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e integritimit evropian të arsimit shqiptar. Strategjia e Universitetit të Tiranës mbështetet mbi tre shtylla themelore: ndërkombëtarizimi, lidhja me tregun e punës dhe forcimi i kërkimit shkencor. Programi MSHSZ reflekton qartë këto shtylla, si në projektimin e kurrikulës, ashtu edhe në zbatimin praktik të saj. Shtylla e ndërkombëtarizimit realizohet përmes integritimit të moduleve të harmonizuara me standardet e EMOS si dhe përmes pjesëmarrjes aktive të programit në marrëveshje ndërinstitucionale brenda kuadrit të Erasmus+, duke lehtësuar mobilitetin dhe bashkëpunimin akademik ndërkombëtar. Lidhja me tregun e punës sigurohet nëpërmjet komponentëve praktikë të programit, ku praktikës profesionale i jepet një rol qendror. Ajo organizohet në bashkëpunim të ngushtë me institucione të rëndësishme publike si INSTAT, me të cilin institucioni ruan një marrëdhënie funksionale dhe të qëndrueshme. Për më tepër, konsultimet periodike me aktorë të tregut të punës kanë ndikuar drejtpërdrejt në rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të</p>

	<p>përmbajtjes së programit. Së fundi, programi inkurajon dhe mundëson përfshirjen aktive të studentëve në projekte kërkimore shkencore dhe në publikime të përbashkëta me stafin akademik, duke ndërtuar një kulturë të qëndrueshme kërkimore që përputhet me praktikat më të mira të arsimit të lartë evropian dhe me prioritetet e strategjisë institucionale.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.0: Propozimi për hapjen e MSHSZ; Ev. 1.2: Rregullore UT; Ev. 1.3: Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit evidentohet si në përputhje të plotë me prirjet globale dhe zhvillimet më të fundit në fushën e statistikave zyrtare. Ai ndjek modelin EMOS, një kornizë e miratuar nga Eurostat, që synon harmonizimin e programeve akademike në këtë fushë brenda vendeve të Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Projektimi i kurrikulës është bërë në përputhje të drejtpërdrejtë me Strategjinë Kombëtare të Statistikës 2021-2027, duke reflektuar objektivat afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të statistikave zyrtare në Shqipëri. Njëkohësisht, programi mbështet objektivat e Eurostat në drejtim të harmonizimit, standardizimit dhe modernizimit të sistemeve statistikore, duke përgatitur specialistë të aftë të operojnë në një kontekst ndërkombëtar dhe shumë teknik. Kurrikula përfshin module të përafuara me përmbajtjen dhe strukturën e programeve EMOS, duke siguruar që studentët të përvetësojnë kompetenca të krahasueshme me kolegët e tyre në vendet anëtare të BE-së. Ky fakt përbën një avantazh të rëndësishëm për integrimin profesional të tyre në tregun evropian të punës, si dhe për kontributin në rritjen e cilësisë së statistikave në nivel kombëtar. Për më tepër, programi pasqyron qartë prirjet më të reja të digjitalizimit dhe të përdorimit të teknologjive të avancuara në prodhimin dhe analizën e statistikave. Kjo vërehet në përfshirjen e lëndëve si "Big Data në statistikat zyrtare" dhe "Metodat moderne të analizës", të cilat janë në linjë me qasjet më bashkëkohore në këtë fushë, të mbështetura edhe nga institucionet ndërkombëtare statistikore.</p> <p><i>GVJ rekomandon që përshtatja e emërimit të programit dhe me Data Science, do e bënte programin më atraktiv për studentët.</i></p> <p><i>Referenca: Ev. 2.0: Propozimi MSHSZ; Evidenca partneritetet ndërkombëtare</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Statistikë Zyrtare" është në përputhje të plotë me misionin, qëllimet dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, duke respektuar Statutin dhe aktet</i></p>

	<p><i>rregullatore përkatëse. Programi kontribuon në ruajtjen dhe promovimin e interesave dhe vlerave kombëtare, duke integruar elementë të rëndësishëm të kulturës akademike dhe identitetit kombëtar në përmbajtjen e tij.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që përshtatja e emërimit të programit dhe me Data Science, do e bënte programin më atraktiv për studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe DSIZ kanë përvojë të gjatë akademike dhe kërkimore (që nga 1952). Personeli i angazhuar në program (13 anëtarë) mbulon të gjitha fushat përkatëse. Fakulteti i Ekonomisë dhe DSIZ kanë një traditë të gjatë akademike dhe kërkimore në fushën e statistikës dhe informatikës së zbatuar. Evidencat e RVB tregojnë se personeli akademik ka eksperiencë të gjerë në mësimdhënie dhe kërkim, me një numër të konsiderueshëm publikimesh dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare. Kjo tregon se programi është i mbështetur nga një bazë e fortë intelektuale, që garanton cilësi të lartë akademike. Në zhvillimin e këtij programi studimi, janë angazhuar gjithsej 13 anëtarë të personelit akademik, nga të cilët 10 janë PAE, ku 4 mbajnë titullin Profesorë, 4 Profesorë të Asociuar, 1 Lektorë me gradën “Doktor” dhe 1 në process doktoratureë.</p> <p><i>Referenca: Ev. Aneks Tabela 6.1; Ev. 2.10: CV të Stafit; Ev. 2.7: Syllabuset; Ev. 2.10; Aneks, Tabelat Përmbledhëse Tabela</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p>	<p>Programi i studimit paraqet një përputhje të qartë dhe të dokumentuar me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse, përkatësisht Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ), pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit - që mbulon statistikat zyrtare, metodat kuantitative, ekonometrikën dhe përdorimin e teknologjive moderne në analizën e të dhënave - është në përputhje të plotë me profilin shkencor dhe ekspertizën e</p>

<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>zhvilluar nga DSIZ. Kjo njësi përqendrohet tradicionalisht në fushat e statistikës së zbatuar, ekonometrisë dhe informatikës së aplikuar, duke siguruar një bazë solide kërkimore dhe akademike për mbështetjen e programit. Struktura e programit, siç evidentohet në planin mësimor dhe syllabus-et përkatëse, është ndërtuar në mënyrë që të reflektojë drejtpërdrejt fushën e specializimit të departamentit. Modulet përmbajnë përmbajtje të avancuar që mbulojnë aspektet teorike dhe praktike të statistikave zyrtare dhe analizës së të dhënave, çka garanton zhvillimin e njohurive dhe aftësive të specializuara në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të klasifikimit të programeve të studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që integrimi i metodave të inteligjencës artificiale dhe analitikës së avancuar në kurrikul, do ta bëjë programin më konkurrues.</i></p> <p><i>Referenca: Ev. 03: Rregullore e Programit; Ev. 2.7: Syllabuset; Ev. Aneks Tabela 9: Plani mësimor</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Statistikë Zyrtare” (MSHSZ) është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse dhe të njësisë kryesore, përkatësisht Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ) dhe Fakultetit të Ekonomisë (FE) pranë Universitetit të Tiranës. Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) përcakton qartë se DSIZ është njësi bazë përgjegjëse për projektimin, zhvillimin dhe menaxhimin akademik të programit, ndërsa Fakulteti i Ekonomisë mban përgjegjësinë institucionale si njësi kryesore për ofrimin e programit. Kjo ndarje është në përputhje me rregulloret dhe aktet normative të brendshme të institucionit dhe garanton një funksionim të qartë dhe efektiv të strukturës akademike dhe administrative. Fusha akademike dhe kërkimore e DSIZ është e orientuar drejt statistikës së zbatuar, ekonometrisë dhe informatikës, duke mbuluar tërësisht përmbajtjen dhe orientimin tematik të programit. Si e tillë, përputhshmëria midis fushës së programit dhe fushës kërkimore të njësisë bazë është e plotë dhe e mbështetur në ekspertizën e personelit akademik dhe në përvojën kërkimore të akumuluar ndër vite.</p> <p><i>Referenca: Ev. 21.6: Konferencat shkencore; Revista shkencore e FE</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet</p>

<p>“Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, nëpërmjet Fakultetit të Ekonomisë (FE) dhe në bashkëpunim me institucione dhe aktorë të tregut të punës, ofron mundësi për trajnime profesionale shtesë për studentët e diplomuar në programin Master Shkencor në “Statistikë Zyrtare” (MSHSZ). Këto trajnime realizohen në koordinim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe përfshijnë një sërë aktiviteteve që synojnë zhvillimin e mëtjshëm profesional dhe përmirësimin e aftësive të kërkuara në tregun e punës. Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) dokumenton angazhimin e institucionit në krijimin e mundësive të formimit të vazhduar për studentët dhe të diplomuarit, përmes bashkëpunimeve të strukturuar me punëdhënësit dhe partnerë të ndryshëm institucionalë. Këto nisma përfshijnë seminare, trajnime të shkurtra, çertifikime profesionale dhe pjesëmarrje në projekte të përbashkëta, që synojnë përshtatjen e kompetencave të të diplomuarve me kërkesat dinamike të tregut të punës.</p> <p><i>Referenca: Ev. 20.3: Studentët këshillim karriere; Marrëveshja UT-AKPA</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master Shkencor në “Statistikë Zyrtare” është në përputhje të plotë me misionin, strategjinë dhe fushat kërkimore të njësive përkatëse përgjegjëse, duke reflektuar qartësisht prioritetet kombëtare dhe prirjet evropiane në fushën e statistikave zyrtare. Programi ofron një strukturë akademike të harmonizuar me modelin EMOS dhe garanton zhvillim profesional përmes bashkëpunimeve me punëdhënësit dhe ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që integrimi i metodave të inteligjencës artificiale dhe analitikës së avancuar në kurrikul, do ta bëjë programin më konkurrues.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti i Tiranës garanton një bashkëpunim të efektshëm dhe të organizuar ndërmjet njësive akademike për hartimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit. Bashkëpunimi mes njësive kryesore dhe njësive bazë është i strukturuar përmes mekanizmave dhe strukturave institucionale të përcaktuara, të cilat lehtësojnë koordinimin dhe sigurimin e integritetit akademik dhe administrativ të programeve. Nga takimet e zhvilluara në institucion, konstatohet se bashkëpunimi i brendshëm funksionon në mënyrë efektive dhe është i dokumentuar në mënyrë adekuate, duke garantuar kështu një proces të qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit akademik.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.1: Statuti i UT; Ev. 1.2: Rregullore UT; Ev. 1.6: Rregullore e Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi të qëndrueshme me institucione homologe ndërkombëtare dhe aktorë të biznesit vendas dhe të huaj, të cilat mbështesin realizimin efektiv të objektivave mësimore dhe formuese të studentëve. Universiteti i Tiranës ka nënshkruar 261 marrëveshje brenda programit Erasmus+ dhe 108 marrëveshje bilaterale, të cilat ofrojnë mundësi të shumta për mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Programi i studimit përfiton në mënyrë të drejtpërdrejtë nga këto bashkëpunime, duke i mundësuar studentëve të zhvillojnë eksperiencë ndërkombëtare, një faktor kyç që, sipas vlerësimit të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), kontribuon ndjeshëm në rritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së programit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca marrëveshje Erasmus+; Raportet vjetore FEUT 2022-2024; Ev. 22.1 Marrëveshjet Ndërinstitucionale; Ev. Aneks Tabelat Përmbledhëse Tabela 5; https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me</p>	<p>Programi i studimit është i mbështetur nga marrëveshje të posaçme bashkëpunimi me institucione relevante në fushën e statistikave zyrtare, për realizimin e praktikave profesionale. Ndër partnerët kryesorë përmenden Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Eurostat,</p>

<p>institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.</p>	<p>me të cilët janë vendosur marrëveshje që mundësojnë zhvillimin e praktikave të strukturuar dhe të mbikëqyrura për studentët. Këto bashkëpunime u ofrojnë studentëve përvojë të drejtpërdrejtë në institucione të profilit përkatës, duke i pajisur me aftësi të aplikueshme në tregun e punës dhe duke i përgatitur për sfidat profesionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky komponent përbën një nga pikat më të forta të programit dhe një kontribut të rëndësishëm në garantimin e cilësisë dhe punësueshmërisë së të diplomuarve.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.0: Propozimi MSHSZ; Ev. Aneks Tabela 5; Ev. 2.9.2: Formular miratimi praktika mësimore Master Shkencor; Ev. 2.9.3: Formular i vlerësimit të studentit praktika mësimore Master Shkencor; Ev. 2.9.4: Format i raportit përfundimtar i praktikës mësimore; Ev. 2.9.5: Formular i vlerësimit të studentit praktikant nga pedagogu udhëheqës Master Shkencor</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit harton në mënyrë periodike raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, në funksion të realizimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit. Këto raporte janë të integruara në raportet vjetore të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ), duke reflektuar analizën e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ndikimin e tyre konkret në formimin akademik dhe profesional të studentëve, si dhe në zhvillimin e stafit. Raportet janë të mirëstrukturuara dhe përmbajnë të dhëna të vlefshme për vlerësim dhe vendimmarrje institucionale.</p> <p><i>Referenca: Ev. 21.1: Raporti vjetor 2022-2023; Ev. 21.2: Raporti vjetor 2023-2024</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Master i Shkencave në "Statistikë Zyrtare" përmbush në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme standardet e akreditimit, duke u bazuar në një dokumentacion të strukturuar dhe evidenca të qarta të paraqitura në Raportin e Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB). Referencat e dokumentuara në RVB konfirmojnë përputhjen e programit me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe me standardet kombëtare dhe evropiane të cilësisë në arsimin e lartë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1		
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.		
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve	
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Struktura e programit Master i Shkencave në “Statistikë Zyrtare” është e ndërtuar në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe me parimet e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi parashikon një ngarkesë totale prej 120 ECTS, të shpërndarë në mënyrë të balancuar ndërmjet komponentëve teorikë, praktikës profesionale dhe punës kërkimore individuale për përgatitjen e tezës së diplomës. Dokumentacioni përkatës, përfshirë planin mësimor dhe syllabus-et, është i mirëstrukturuar dhe i aksesueshëm për studentët, duke siguruar transparencë dhe orientim të qartë gjatë gjithë ciklit të studimeve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se struktura e programit është në përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, duke garantuar krahasueshmëri ndërkombëtare dhe mbështetje të plotë për lëvizshmërinë akademike. Plani mësimor i këtij program është i organizuar sipas veprimtarive formuese bazuar në VKM Nr. 41, 24.01.2018 (i ndryshuar) dhe është ndarë në module e lëndë të vlerësuara në ECTS:	
	Kategoria A	LËNDË BAZË - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme
	Kategoria B	LËNDË KARAKTERIZUESE - përgatitje për disiplinën shkencore
	Kategoria C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE - nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje
		10%
		50%
		15%

	Kategoria D	LËNDË PLOTËSUESE - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10%
	Kategoria E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	15%
<i>Evidenca: Ev. 1.2: Rregullore e UT; Ev. Aneks Tabela 9: Plani mësimor.</i>			
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<p>Programi Master i Shkencave në “Statistikë Zyrtare” synon të zhvillojë njohuri të thelluara dhe aftësi të avancuara në fushën e statistikave zyrtare, duke përbushur kërkesat e këtij kriteri në mënyrë të plotë. Plani mësimor paraqet një strukturë të qartë të ndarjes së lëndëve sipas semestrave dhe ngarkesës në ECTS, çka siguron koherencë të procesit mësimor dhe lehtëson ndjekjen e programit nga studentët. Syllabuset dëshmojnë fokusin e programit në zhvillimin e kompetencave teknike dhe analitike, përmes përdorimit të metodave të avancuara statistikore dhe aplikimit të softuerëve bashkëkohorë si R, Python dhe SPSS. Kjo qasje përgatit studentët për të adresuar probleme komplekse dhe të paparashikueshme në një mjedis profesional ose akademik të specializuar.</p> <p><i>Referenca:</i> Ev. 2.0: Propozimi MSHSZ; Ev. 2.7: Syllabuset e lëndëve</p>		
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Programi i Studimit ka të përcaktuara qartë ngarkesën në kredite për komponentët e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe praktikat ndërkombëtare të arsimit të lartë. Rregullorja e programit specifikon kriteret për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët. Teza e Masterit zë një peshë të konsiderueshme në kurrikulën e programit, me një ngarkesë prej 18 ECTS, duke i mundësuar studentit të zhvillojë një punim të thelluar kërkimor dhe/ose praktik, në përputhje me objektivat e formimit profesional. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vlerëson se kjo ndarje është në përputhje me standardet evropiane dhe përbën një komponent të rëndësishëm në garantimin e cilësisë së diplomës së lëshuar.</p>		

	<i>Referenca: Ev. 03: Rregullore e Programit.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Ky kriter nuk aplikohet
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Ky kriter nuk aplikohet
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat	Ky kriter nuk aplikohet




përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.									
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme	Ky program studimi ofrohet vetëm nga Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës.								
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në lidhje me kodifikim e programit të studimit priten përgjigjet nga ministria përgjegjëse. (në vijim të VKM-së 310, datë 11.05.2022) Ndërkohë nga QSHA kodi unik i porgramit të studimit është: UT4627190582								
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet								
Konkluzione	<i>Programi i studimit është ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe me parimet e Sistemit Evropian të Krediteve (ECTS), duke siguruar balancë ndërmjet përmbajtjes teorike, praktikës profesionale dhe kërkimit shkencor. Struktura e programit dhe dokumentacioni përkatës dëshmojnë qartësi, koherencë dhe transparencë në organizimin e ciklit të studimeve.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbysh kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbysh detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia Bazë përmbysh plotësisht kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", lidhur me strukturën dhe organizimin akademik. Gjatë procesit të vlerësimit, konstatoam se departamenti disponon një personel akademik të kualifikuar dhe kapacitete të mjaftueshme njerëzore e institucionale, të cilat garantojnë funksionimin efektiv dhe cilësor të programit të studimit.</p> <p>Personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kontratë i fakultetit të Ekonomisë, për vitin e fundit akademik është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="592 869 1326 1317"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2024-2025</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>28</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>50</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>41</td> <td>40</td> </tr> <tr> <td>Dr. në proc</td> <td>49</td> <td>48</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td></td> <td>115</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>168</td> <td>221</td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kontratë i Departamentit të statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, për vitin tre vitet e fundit akademike është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="592 1514 1337 1908"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> <th colspan="2">2024-2025</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>6</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>6</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>9</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>12</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>7</td> <td>22</td> <td>13</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td>Dr. proc</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2024-2025		PAE	PAK	Prof. Dr	28	6	Prof. Asoc.	50	12	Dr/Phd	41	40	Dr. në proc	49	48	Msc.		115	Gjithsej	168	221	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	6	2	0	1	6	1	Prof. Asoc.	9	2	2	-	12	5	Dr/Phd	7	22	13	1	5	14	Dr. proc	0	0	0		0	0
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2024-2025																																																																
	PAE	PAK																																																															
Prof. Dr	28	6																																																															
Prof. Asoc.	50	12																																																															
Dr/Phd	41	40																																																															
Dr. në proc	49	48																																																															
Msc.		115																																																															
Gjithsej	168	221																																																															
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																											
Prof. Dr	6	2	0	1	6	1																																																											
Prof. Asoc.	9	2	2	-	12	5																																																											
Dr/Phd	7	22	13	1	5	14																																																											
Dr. proc	0	0	0		0	0																																																											

	Msc.	10	40	3	37	11	39
	Gjithsej	32	66	36	53	34	59
	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ), si njësi bazë akademike pranë Fakultetit të Ekonomisë, është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e programeve të studimit në fushat përkatëse. Ky departament përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi lidhur me: Strukturën akademike; përbërjen dhe kualifikimet e stafit akademik; organizimin e mësimdhënies; vlerësimin dhe akreditimin institucional dhe të programeve të studimit.</p> <p>Pjesa më e madhe e ngarkesës mësimore në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar mbulohet nga personeli akademik me kohë të plotë.</p> <p><i>Referenca:</i> Ev. 1.2: Rregullore UT; Statuti i UT; Ev. Tabelat Përmbledhëse – Tabelat 1 dhe 2.</p>						
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel ndihmës akademik dhe administrativ për realizimin e komponentëve praktikë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Programi përfshin komponentë laboratorikë dhe praktikë, të cilët kërkojnë mbështetje teknike dhe logjistike të specializuara. Sipas evidencave të paraqitura, personeli ndihmës është i përfshirë në mënyrë aktive në zhvillimin e laboratorëve dhe seminareve praktike, duke kontribuar në funksionimin e tyre të rregullt dhe në përmirësimin e përvojës së studentëve. Praktika profesionale në programin e studimit zhvillohet në institucione dhe kompani që përputhen me profilin profesional dhe akademik të studentëve.</p> <p>Procesi i praktikës profesionale është i strukturuar dhe i mbikqyrur në mënyrë të dyfishtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> nga një pedagog i caktuar nga Departamenti, i cili ndjek progresin akademik dhe përmbajtjen e praktikës; si dhe nga një përfaqësues i institucionit pritës, i cili siguron mbështetje në aspektin profesional dhe integrimin e studentit në mjedisin e punës. <p>Ky bashkëpunim siguron cilësi dhe përputhshmëri të praktikës me objektivat e programit të studimit, si dhe ndihmon në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, në funksion të përgatitjes së tyre për tregun e punës.</p>						

	<i>Referenca: Aneks Tabelat Përmbledhëse - Tabela 1: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë FEUT</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës, programi i studimit ka të përcaktuar një koordinator me qëllim ndjekjen e ecurisë së programit. Ky mekanizëm është i formalizuar në rregulloren e programit dhe siguron funksionimin efektiv të strukturave përgjegjëse për menaxhimin akademik dhe administrativ të programit. Koordinatori i programit ka një rol aktiv dhe të mirëstrukturuar, duke përfshirë Drejtimin e komisionit të Programit të Studimit; Koordinimin e aktiviteteve me strukturat institucionale; Mbikëqyrjen e përditësimit të planit mësimor dhe syllabuseve; Sigurimin e aksesit të studentëve në materialet mësimore; Bashkëpunimin në analizën vjetore dhe rishikimin e programit; Ndërveprimin me palët e interesuara dhe tregun e punës; Kontributin në aktivitetet informuese dhe promovuese të programit. Gjithashtu, përgjegjësi i njësisë bazë, në bashkëpunim të ngushtë me koordinatorin, organizon, koordinon dhe mbikëqyr procesin e zhvillimit të programit të studimit, duke garantuar përputhshmërinë me standardet institucionale dhe nevojat e tregut të punës.			
	<i>Referenca: Ev. 1.1: Statuti i UT; Ev. 03: Rregullore e Programit.</i>			
Konkluzione	<i>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush në mënyrë të plotë kërkesat ligjore dhe institucionale, duke disponuar personel akademik të kualifikuar, mbështetje ndihmëse për komponentët praktikë dhe një strukturë funksionale menaxhimi. Organizimi i praktikave profesionale dhe roli aktiv i koordinatorit të programit kontribuojnë ndjeshëm në sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e vazhdueshëm të programit, në përputhje me nevojat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse	Gjatë procesit të vlerësimit u konstatua se njësia kryesore dhe njësia bazë disponojnë të gjitha informacionet dhe dokumentet e

<p>për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Plani mësimor, i ndërtuar sipas aktiviteteve formuese dhe i miratuar çdo fillim viti akademik nga autoritetet përkatëse, paraqet në mënyrë të qartë përbërjen e programit dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët. Syllabuset e lëndëve janë të mirëstrukturuara, përmbajnë objektiva, përmbajtje, rezultatet e të nxëniet dhe metodologji të mësimdhënies e të vlerësimit. Gjithashtu, rregullorja e programit dhe rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT garantojnë funksionimin efektiv dhe monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit.</p> <p><i>Referenca: Ev. 03: Rregullore e Programit; Ev. 2.7: Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit përmban një plan mësimor të strukturuar në mënyrë të qartë, ku pasqyrohet ndarja e lëndëve sipas semestrave, si dhe ngarkesa mësimore për çdo lëndë, përfshirë orët në auditor dhe jashtë auditorit.</p> <p>Plani mësimor respekton kërkesat ligjore dhe institucionale, duke ofruar një strukturë të qartë dhe të balancuar të ngarkesës akademike gjatë gjithë ciklit të studimit.</p> <p><i>Referenca: Ev. Aneks Tabela 9: Plani mësimor.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret institucionale. Këto elementë janë të formalizuar në rregulloren e programit, ku përcaktohen në mënyrë të qartë procedurat dhe kushtet për pranimin e studentëve të rinj, pranimin për studentët e transferuar nga institucione të tjera, njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve dhe lëndëve të mëparshme.</p> <p><i>Referenca: Ev. 03: Rregullore e Programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues</p>	<p>Programi i studimit përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë, duke përfshirë të gjithë komponentët formues, si praktikant, seminarët dhe orët e laboratorit, në përputhje me formatet dhe standardet akademike të miratuara. Syllabuset janë strukturuar sipas kërkesave të VKM nr. 41 dhe përmbajnë informacion të plotë mbi objektivat e mësimdhënies, metodologjinë, literaturën, kriteret e vlerësimit, rezultatet e të nxëniet, si dhe përmbajtjen e ndarë sipas javëve mësimore dhe tematikave të detajuara. Plani mësimor jep</p>

të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	informacion të qartë dhe të detajuar për ndarjen e lëndëve, strukturën e tyre dhe komponentët brenda dhe jashtë auditorit, duke siguruar transparencë dhe qartësi për studentët dhe stafin akademik. <i>Referenca: Ev. 2.7: Syllabuset</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmbajtja e programit të studimit përditësohet rregullisht çdo vit akademik, ku bëhen rishikime të detajuara të planeve mësimore dhe përmbajtjes së programit nga personeli akademik nën drejtimin e Drejtuesit të Departamentit. Ndryshimet e bëra janë të argumentuara dhe të përputhura me legjislacionin në fuqi, duke mundësuar deri në 20% rishikim të programit. Programi i studimit reflekton zhvillimet e fundit në fushën e statistikave zyrtare dhe teknologjisë, duke garantuar përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje me kërkesat aktuale të tregut dhe kërkimeve shkencore. Dokumentacioni kryesor është i arkivuar në gjuhën shqipe, ndërsa pjesë e dokumentacionit si syllabuset dhe suplementi i diplomës janë të disponueshme edhe në gjuhën angleze, duke siguruar akses ndërkombëtar dhe përdorim të literaturës bashkëkohore në këtë gjuhë. <i>Evidenca: Procesverbale Departamenti DSIZ; Ev. 2.6: Suplementi i Diplomës MSHSZ; Ev. 2.7: Syllabuset e lëndëve</i>			
Konkluzione	<i>Njësia bazë disponon dokumentacion të plotë dhe të përditësuar, që garanton organizimin dhe funksionimin efektiv të programit. Programi i studimit është i strukturuar qartë, me kritere transparente për pranimin dhe përmirësimet të vazhdueshme, duke iu përshtatur nevojave akademike dhe tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,	Emërtimi dhe struktura e programit, përfshirë përmbajtjen dhe shpërndarjen e lëndëve dhe praktikave, sigurojnë thellimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për studime të mëtejshme dhe punësim. Plani mësimor përmban lëndë të avancuara që përputhen

<p>thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>me Kornizën Kombëtare dhe Evropiane të Kualifikimeve, duke garantuar një përgatitje cilësore në fushën e statistikave zyrtare.</p> <p><i>Referenca: Ev. Aneks Tabela 9: Plani mësimor</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit përmban një strukturë të qartë dhe të balancuar të lëndëve dhe moduleve, të shpërndara në dy vite dhe katër semestra, me vlerësim në kredite dhe orë mësimore. Ky plan mësimor i ndihmon studentët të arrijnë objektivat formues dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Lëndët e formimit bazë, profesionale dhe ato për aftësitë komunikuese dhe prezantuese janë të përzgjedhura dhe të strukturuar në mënyrë që të sigurojnë zhvillimin e kompetencave profesionale dhe kërkimore të studentëve, duke mbështetur misionin e programit për specializim dhe aftësim efektiv në fushën e statistikave zyrtare.</p> <p><i>Referenca: Ev. 03: Rregullore e Programit; Ev. 2.0: Propozimi</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Për krijimin e këtij programi studimi, Departamenti ka bazuar zhvillimin e tij mbi praktikën më të avancuar dhe standardet e universiteteve të njohura ndërkombëtare. Iniciativa për këtë program ka lindur si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me Institutin e Statistikave (INSTAT), në kuadër të projektit EMOS. INSTAT, si një prej punëdhënësve kryesorë të të diplomuarve, ofron kontribut praktik përmes angazhimit të lektorëve, organizimit të praktikave profesionale dhe mundësive për punësim të studentëve më të suksesshëm të këtij programi. Programi është konceptuar në përputhje të plotë me profilin akademik dhe profesional të ciklit të dytë të studimit, si dhe me standardet e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Krediteve (ECTS). Kurrikula është strukturuar në mënyrë të balancuar gjatë katër semestrave, duke garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës akademike dhe një kombinim efektiv të njohurive teorike dhe praktikës profesionale, me qëllim sigurimin e aftësive dhe kompetencave të thelluara për studentët në fushën e statistikave zyrtare.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.7: Syllabuset; Tabelat përmbledhëse (tab. 10)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,</p>	<p>Ndarja e veprimtarive formuese në programin e studimit është në përputhje të plotë me VKM Nr. 41/2018 dhe siguron një raport të balancuar midis formimit teorik dhe praktik. Kjo strukturë, e përshkruar në planin mësimor, rregulloren e programit dhe syllabuset përkatëse, garanton arritjen e objektivave formues dhe profilizimin profesional të studentëve. Përmes realizimit të</p>

<p>transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>praktikave profesionale dhe strukturës së përshtatur, programi lehtëson integrimin e studentëve në tregun e punës. Gjithashtu, ndarja sipas veprimtarive formuese mundëson transferimin e krediteve mes institucioneve të arsimit të lartë brenda vendit dhe ofron mundësi për mobilitet ndërkombëtar përmes marrëveshjeve dhe programeve si Erasmus+, duke përmirësuar kështu fleksibilitetin dhe lëvizshmërinë akademike të studentëve.</p> <p><i>Referenca: Ev. 03 Rregullore e programit të studimit MSHSZ; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 17.5 DSIZ ALUMNI Raport mbi Punësimin; Ev. Aneks Tabelat Përmbledhëse - Tabela 10: Plani mësimor</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e programit përditësohen vazhdimisht për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës, me fokus kryesor në literaturën bazë dhe ndihmëse të pesë viteve të fundit. Ky përditësim reflektohet qartë në seksionin përkatës të syllabuseve.</p> <p><i>Personeli akademik të rifreskojë literaturën e përdorur në lëndë me botime të pesë viteve të fundit, duke përfitur edhe nga përvojat dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, si dhe nga mobiliteti i stafit.</i></p> <p>Një pikë e fortë e insitucionit është që personeli dhe studentët kanë akses në biblioteka elektronike si JSTOR, U-library dhe COBISS, duke siguruar burime të bollshme dhe cilësore për mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.7: Syllabuset e lëndëve; Ev. 11.6.4: Biblioteka-Manual_JSTOR; Ev. 11.6.6: Manual Ulibrary; Ev. 11.6.8: Lista e Librave të rinj 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje të plotë me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara për përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale. Syllabuset e lëndëve tregojnë një përmbajtje të pasur didaktike, profesionale dhe shkencore që garanton arritjen e rezultateve të pritshme për nivelin master i shkencor, <i>por literatura mbetet një rekomandim për tu përmbushur me botime të pesë viteve të fundit duke ju përmbajtur legjislacionit në fuqi.</i> Programi kombinon në mënyrë të balancuar teorinë, kërkimin dhe praktikën, duke nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe kreativ të studentëve, në përputhje me standardet e ciklit të dytë të studimeve.</p> <p><i>Referenca: Ev. 03 Rregullore e programit të studimit MSHSZ; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve</i></p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është e strukturuar në mënyrë që të mundësojë jo vetëm përgatitjen profesionale të studentëve për tregun e punës, por edhe vijimin e suksesshëm të studimeve të mëtejshme. Programi është i përshtatur me kërkesat dhe pritshmëritë aktuale të tregut, duke ofruar njohuri dhe kompetenca të nevojshme për punësim efektiv dhe zhvillim profesional. Kjo strukturë garanton që studentët të jenë konkurrues dhe të aftë të përballojnë sfidat e karrierës dhe arsimit të avancuar. Konkretisht, 92% e të diplomuarve janë punësuar në përputhje me fushën e studimit, duke dëshmuar efikasitetin e programit në përmbushjen e pritshmërive dhe kërkesave të tregut profesional.</p> <p><i>Referenca: Ev. Aneks Tabelat Përmbledhëse - Tabela 10: Plani mësimor; Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është i strukturuar në mënyrë të balancuar dhe përputhet plotësisht me kërkesat akademike dhe të tregut të punës, duke garantuar thellimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale të studentëve.</i></p> <p><i>Personeli akademik të përditësojë literaturën në syllabuset e lëndëve, duke përfshirë më shumë botime të publikuara në pesë vitet e fundit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>Ky program studimi demonstroi një proces të strukturuar dhe të qëndrueshëm konsultimi me aktorë të rëndësishëm nga tregu i punës, përfshirë punëdhënës si INSTAT, ish-studentë dhe institucione të tjera partnere. Këto konsultime zhvillohen në mënyrë të rregullt dhe përdoren në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, duke siguruar përputhjen e tij me zhvillimet aktuale dhe nevojat reale të tregut të punës. Integrimi i rekomandimeve të marra nga këta aktorë dhe përfshirja e ekspertëve nga fusha praktike në procesin mësimor përforcojnë më tej këtë</p>

<p>institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>lidhje, duke dëshmuar një angazhim të qartë institucional për rritjen e cilësisë akademike dhe përgatitjen e studentëve për sfida konkrete profesionale.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.0 Propozimi Master Shkencor në Statistika Zyrtare; Ev. 2.5: Marrëveshja FEUT-INSTAT; Ev. 17.5: DSIZ ALUMNI Raport mbi Punësimin</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e zhvilluar në institucion si dhe dokumenti mbështetës i RVB, konstatohet se institucioni ka ngritur një mekanizëm gjithëpërfshirës për përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve në procesin e përmirësimit të programeve të studimit. Përfshirja e studentëve në diskutimet akademike dhe vendimmarrjen për përmbajtjen e kurrikulës bëhet në përputhje me Statutin dhe Strategjinë e Zhvillimit të UT. Përdorimi i rregullt i instrumenteve të vlerësimit si pyetësorët e studentëve për lëndët dhe pedagogët, të administruar nga NJBSC, ofron të dhëna të rëndësishme që merren parasysh në analizat për përmirësime të mundshme. Gjithashtu, institucioni ruan kontakte të qëndrueshme dhe aktive me të diplomuarit përmes një rrjeti funksional Alumni, duke i përfshirë në veprimtari të ndryshme akademike, si konferenca shkencore, apo konsultime për zhvillimin e mëtejshëm të programit.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.1 Statuti i UT; Ev. 1.3 Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028; Ev. 4.2 UT Studimi i tregut të punës 2022; Ev. 12.6 FE Alumni Pyetsor; Ev. 17.1 Raport NJSBC 2022-2023; Ev. 17.1.1 Raport NJSBC 2024-2025, semestri 1; Ev. 17.1.2 Raporti NJSBC 2024-2025, semestri 2; Ev. 17.3 FE Pyetsor vlerësimi i lëndës nga studenti; Ev. 17.4 FE Pyetsor vlerësimi për pedagogun nga student</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Bashkëpunimi i vazhdueshëm mes INSTAT dhe Departamentit të Statistikës dhe Informatikës Zbatuese (DSIZ) ka kontribuar si në përmirësimin e përmbajtjes së programit, ashtu edhe në realizimin e praktikave profesionale për studentët. Ky bashkëpunim gjithashtu garanton që studentët të ekspozohen ndaj standardeve të Eurostat dhe Sistemit Statistikor Evropian (ESS), duke i rritur kështu mundësitë e tyre për integrim në tregun ndërkombëtar të punës. Përfshirja e lektorëve të ftuar, si nga INSTAT ashtu edhe nga universitete partnere ndërkombëtare, kontribuon ndjeshëm në përditësimin e programit dhe në ndërlidhjen e tij me praktikat më të mira profesionale dhe akademike në fushën e statistikave.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.5 Marrëveshja FEUT-INSTAT</i></p>

Konkluzione	<i>Programi i studimit në “Statistikë Zyrtare” është i ndërtuar mbi një mekanizëm funksional dhe gjithëpërfshirës konsultimi me aktorë të tregut të punës, studentë dhe alumni, duke reflektuar rregullisht zhvillimet më të fundit në fushë. Bashkëpunimi i ngushtë me INSTAT dhe përfshirja e lektorëve të ftuar nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare përforcojnë cilësinë akademike dhe relevancën profesionale të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” është i konceptuar në përputhje të qartë me objektivat strategjike të kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës. Dokumentacioni përkatës, përfshirë dokumentin e hapjes së programit, rregulloren dhe syllabuset, pasqyron qartësisht prioritetet dhe objektivat mësimore e kërkimore të programit, të harmonizuara me zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e statistikave zyrtare. Programi përcakton si prioritet formimin e specialistëve me kompetenca të avancuara teorike dhe praktike, të aftë për të përballuar kërkesat në rritje për analiza statistikore në përputhje me standardet e Sistemit Statistikor Evropian (ESS). Gjithashtu, theksohet angazhimi në kërkimin e aplikuar përmes bashkëpunimit me institucione të tilla si INSTAT dhe Banka e Shqipërisë, si dhe përmes pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 2.8 Plane mësimore MSHSZ 22-23-24-25; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike	<p>Nga takimet e zhvilluara në institucion konstatoam se Njësia kryesore dhe ajo bazë demonstrojnë një organizim të mirëstrukturuar dhe efikas në drejtimin dhe koordinimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe kërkimore-shkencore. Politikat institucionale dhe raportet vjetore pasqyrojnë qartë përpjekjet për të bashkërenduar këto aktivitete në mënyrë që të përmbushin objektivat akademike dhe kërkimore në fushën specifike të studimit. DSIZ nxit aktivisht angazhimin e stafit akademik në projekte</p>



<p>të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>kërkimore dhe veprimtari shkencore, duke promovuar pjesëmarrjen në konferenca, publikime dhe projekte që lidhen ngushtë me fushën e statistikave zyrtare. Për më tepër, respektohet liria akademike e pedagogëve në hartimin e syllabus-it, duke u siguruar që kjo të bëhet në përputhje me objektivat e programit, çka nxit kreativitetin dhe specializimin brenda kurrikulës.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 21.3.2 DSIZ raportimi vjetor 2022-2023; Ev. 21.4.1: DSIZ puna kërkimore shkencore 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” (MSHSZ) krijon kushte të favorshme dhe të strukturuar për angazhimin aktiv të studentëve në aktivitete kërkimore dhe projekte shkencore. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës Zbatuese (DSIZ) nxit dhe mbështet përfshirjen e studentëve në punë kërkimore bashkëpunuese me stafin akademik, duke përfshirë punën mbi temën e diplomës dhe realizimin e praktikave profesionale në INSTAT, duke i lidhur në këtë mënyrë drejtpërdrejt me fushën praktike të studimit. Gjithashtu, pjesëmarrja e studentëve në konferenca shkencore si dhe mundësitë për mobilitete ndërkombëtare, si rezultat i projekteve ku angazhohet DSIZ, përforcojnë zhvillimin e aftësive kërkimore, analizës kritike dhe inovacionit akademik. Programi demonstroi angazhim për të krijuar një mjedis që motivon studentët të jenë pjesë aktive të kërkimit shkencor, duke i përgatitur ata për sfidat dhe kërkesat e tregut profesional dhe akademik.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.5 Marrëveshja FEUT-Instat; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 20.16 ICEBIT 2024 Conference Agenda</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, nëpërmjet politikave të tij institucionale dhe strategjike, siguron mbështetje financiare për realizimin e aktiviteteve studimore dhe kërkimore, duke përfshirë edhe programin Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”. Strategjia e Zhvillimit të UT 2023–2028 e përkufizon qartë synimin për rritjen e burimeve financiare për kërkimin shkencor, përmes kombinimit të fondeve të brendshme dhe përthithjes së financimeve nga projekte publike dhe ndërkombëtare, si Erasmus+, Horizon 2020, Jean Monnet, AKKSHI, AUF, etj. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ) është përfshirë në mënyrë aktive në këto projekte, duke demonstruar aftësi të qëndrueshme për të siguruar burime financiare që mbështesin kërkimin shkencor,</p>

	<p>zhvillimin profesional të stafit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës akademike dhe teknologjike. Po ashtu, pjesëmarrja e stafit në konferenca të brendshme dhe ndërkombëtare, organizimi i workshopeve dhe sigurimi i aksesit në burime kërkimore online janë dëshmi të qarta të angazhimit për të krijuar një mjedis që nxit dhe mbështet kërkimin cilësor.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.1 Statuti i UT; Ev. 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028; Ev. 8.2 UT Vendimi nr. 28 Për Grantin në konferenca Shkencore; Ev. 21.7 UT List of previous projects; Ev. 21.3 FE Aktivitetet shkencore 202-2023; Ev. 21.5.1 Projekte në implementin ndërkombëtar; Ev. 21.5.2 Projektet FE 2024 kombëtare</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” demonstroi përputhje të qartë me objektivat strategjike të kërkimit shkencor të UT, duke integruar standardet evropiane dhe praktikat më të mira në fushën e statistikave zyrtare. Programi mbështet aktivisht kërkimin shkencor dhe përfshirjen e studentëve në projekte, konferenca dhe mobilitete ndërkombëtare, ndërsa sigurimi i financimeve nga burime të brendshme dhe të jashtme tregon për një qasje të qëndrueshme dhe të strukturuar në përmirësimin e cilësisë akademike dhe kërkimore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Në përputhje me objektivat institucionale për zhvillimin e kërkimit shkencor, programi Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” gëzon mbështetje të vazhdueshme nga njësia bazë për nxitjen dhe zhvillimin e grupeve kërkimore dhe iniciativave të reja studimore. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ) promovon angazhimin aktiv të stafit në projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, si INSTAT dhe partnerët e BE-së, duke siguruar që aktivitetet kërkimore të jenë të ndërlidhura ngushtë me objektivat akademike të programit dhe me zhvillimet aktuale në fushën e statistikave zyrtare. Ky bashkëpunim ndërdisiplinor dhe institucional</p>

	<p>kontribuon në rritjen e cilësisë kërkimore dhe në përgatitjen e kuadrove të afta për të adresuar sfidat shkencore dhe profesionale.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.5 Marrëveshja FEUT-INSTAT; Ev. 21.4.1 DSIZ Raport Puna kërkimore shkencore 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>DSIZ demonstroi angazhim të qëndrueshëm në përgjigje të kërkesave për analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me objektivat akademike dhe nevojat e tregut. Kjo njësi inicion dhe mbështet zhvillimin e veprimtarive shkencore nëpërmjet përfshirjes së personelit akademik dhe studentëve në projekte të ndryshme, duke stimuluar bashkëpunimin ndërmjet tyre përmes konferencave shkencore, botimeve në revista akademike dhe angazhimit në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Ky bashkëpunim jo vetëm që kontribuon në zhvillimin profesional të stafit dhe studentëve, por edhe në prodhimin e njohurive të reja të aplikuara në fushën e statistikave zyrtare.</p> <p><i>Referenca: Ev. 21.3.2 DSIZ raportimi vjetor 2022-2023; Ev. 21.4.1 DSIZ puna kërkimore shkencore 2023-2024; Ev. 21.7 List of previous projects</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës Zbatuese (DSIZ), në bashkëpunim me njësinë kryesore, është i përfshirë në organizimin dhe pjesëmarrjen e rregullt në aktivitete shkencore që mbështesin objektivat akademike dhe kërkimore të programit të studimit. Edhe pse nuk organizon aktivitete të veçanta në mënyrë të pavarur, DSIZ kontribuon çdo vit në konferencën shkencore të Fakultetit të Ekonomisë, duke krijuar një hapësirë të dedikuar për prezantimin e punimeve të stafit akademik dhe studentëve të programit Master në “Statistika Zyrtare”. Po ashtu, botimi shkencor i Fakultetit përfshin një seksion specifik për kontributet nga DSIZ, ndërsa organizimi i workshopeve dhe aktiviteteve ndërdisiplinore nxit shkëmbimin e ideve dhe zhvillimin e kapaciteteve kërkimore.</p> <p><i>Referenca:</i> https://feut.edu.al/konferenca-botime/konferenca/226-international-conference-on-economy-business-innovation-and-technology-transforming-economy-and-business-through-innovation-and-digital-solutions https://feut.edu.al/konferenca-botime/revista-shkencore/2096-albanian-journal-of-economy-and-business <i>Konferenca - Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës</i></p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Statistika Zyrtare” demonstroi një qasje të qartë dhe koherente për përgatitjen e profesionistëve konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Përmbajtja akademike e programit, e orientuar drejt praktikës dhe në përputhje me standardet e Sistemit Statistikor Evropian, në kombinim me përfshirjen e ekspertëve të fushës dhe mundësitë për mobilitet ndërkombëtar, siguron pajisjen e studentëve me kompetenca të avancuara teorike, analitike dhe profesionale. Ky formim i gjithanshëm rrit aftësinë e tyre për t’u integruar në institucione kërkimore, statistike apo zhvillimore brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.0 Propozimi Master Shkencor në Statistika Zyrtare; Ev. 17.5: DSIZ ALUMNI Raport mbi Punësimin - Pyetësori i FE, pika 3.4</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Master i Shkencave në Statistika Zyrtare tregon një përputhje të qartë me objektivat institucionale për kërkimin shkencor dhe formimin profesional. Aktivitetet kërkimore të ndërmarra nga DSIZ, në bashkëpunim me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përfshirja aktive e studentëve dhe stafit në konferenca, projekte dhe botime, dëshmojnë për një mjedis</i></p>



	<i>akademik të orientuar drejt cilësisë, inovacionit dhe përgatitjes së profesionistëve konkurrues në nivel kombëtar dhe evropian.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” zbaton forma të ndryshme dhe të miratuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies, në përputhje me rregulloret institucionale, legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018) dhe me sistemin e krediteve ECTS. Dokumentacioni i programit përmban përshkrime të qarta mbi metodat e përdorura, përfshirë leksione, seminare, ushtrime praktike, punë laboratorike, ese, detyra kursi, projekte, praktika profesionale dhe forma të tjera ndërvepruese që synojnë zhvillimin e të menduarit kritik dhe angazhimin aktiv të studentëve. DSIZ demonstroi angazhim të vazhdueshëm për të pasuruar përvojën mësimore përmes leksioneve të hapura, workshopeve, vizitave studimore dhe bashkëpunimit të strukturuar me institucione si INSTAT, duke forcuar lidhjen midis teorisë dhe praktikës. Veçanërisht, praktikat profesionale në semestrin e fundit, të realizuara në bashkëpunim me mbi 40 institucione partnere vetëm për vitin akademik 2023-2024, dëshmojnë për integrimin efektiv të komponentëve praktikë në kurrikul dhe përpjekjet për ta bërë formimin e studentëve sa më të orientuar drejt tregut të punës.

	<p><i>Referenca: Ev. 2.0: Propozimi Master Shkencor në statistika zyrtare; Ev. 2.5 Marreveshja feut instat; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Ev. 20.12 FE Leksione të hapura; Ev. 20.13 FE Workshope; Ev. 20.14 DSIZ Workshope; Ev. Ankes Tabelat përmbledhëse-Tabela 5: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare", demonstroi një qasje të diferencuar dhe të përshtatur ndaj nevojave të studentëve, në përputhje me natyrën specifike të fushës dhe objektivat e programit. Stafit akademik i angazhuar në program, i përbërë nga pedagogë me formim të avancuar dhe përvojë të konsiderueshme praktike, përdori metoda bashkëkohore dhe fleksibël të mësimdhënies, si: analiza të rasteve studimore, punë në grupe, ushtrime me softuerë statistikorë si R, Python, Stata, dhe detyra projekti, duke reflektuar kërkesat aktuale të tregut dhe zhvillimet e fushës. Këto forma kontribuojnë në personalizimin e procesit të të nxënies, në zhvillimin e aftësive analitike, praktike dhe bashkëpunuese të studentëve, dhe krijojnë një mjedis që nxit pjesëmarrjen aktive, mendimin kritik dhe përfshirjen në kërkim shkencor. Për më tepër, përdorimi i metodave të mësimdhënies të mbështetura në teknologji dhe përfshirja e punës praktike kontribuojnë në përgatitjen efektive të studentëve për sfidat e tregut të punës kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 2.10 Cv të stafit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies.</p>	<p>Pas vizitës së zhvilluar në institucion, GVJ vlerëson se Fakulteti i Ekonomisë dhe Universiteti i Tiranës sigurojnë mbështetje të qëndrueshme dhe të strukturuar për zhvillimin profesional dhe akademik të personelit akademik. Përmes trajnimeve pedagogjike, mobiliteteve ndërkombëtare, si dhe aktiviteteve të organizuara nga Qendra e Zhvillimit Profesional, stafi përfiton mundësi të vazhdueshme për përmirësimin e kompetencave didaktike dhe kërkimore, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies. Për më tepër, mbështetja financiare dhe akademike për doktorantët dhe pjesëmarrja aktive e stafit në projekte kërkimore të financuara nga universiteti rrit cilësinë e mësimdhënies dhe promovon kulturën e kërkimit shkencor, duke krijuar një mjedis stimulues për avancimin profesional dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.</p>

	<p><i>Referenca: 8.15 Lista e fituesve në programin e doktoraturës DSIZ; Ev. 10.4.1.1 DSIZ Mobilitete Outgoing Staf Akademik; Ev. 21.1: Raporti vjetor FEUT 2022-2023; Ev. 21.3.2 DSIZ Raportim Vjetor 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, vizitës së kryer në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”, përmbush standardet e kërkuara për kompetencë profesionale dhe didaktike. Stafi përbëhet nga pedagogë të kualifikuar me tituj akademikë dhe gradë shkencore përkatëse, dhe përfshirja e tyre në veprimtari kërkimore e rrit më tej cilësinë e mësimdhënies. Metodatat e përdorura janë interaktive dhe të fokusuar te studenti, duke përfshirë diskutime, punë në grup, detyra kursi, raste studimore dhe punë laboratorike me mjete statistikore bashkëkohore. Kjo qasje pedagogjike kontribuon në zhvillimin e mendimit kritik, kreativ dhe autonom të studentëve, ndërkohë që sigurohet një marrëdhënie respekti dhe mbështetjeje të ndërsjellë midis stafit dhe studentëve gjatë gjithë procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit. Gjatë vitit akademik 2023-2024, vërehet një mungesë e theksuar e stafit të angazhuar në programin Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”, me vetëm 3 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë dhe 2 me kohë të pjesshme. Në vitin akademik pasardhës, është evidente një përmirësim i ndjeshëm në numrin e stafit të angazhuar, duke reflektuar përpjekje institucionale për përmirësimin e burimeve njerëzore.</p> <p><i>Rekomandohet që trendi pozitiv i rritjes së stafit të vijojë në mënyrë të qëndrueshme edhe në vitet e ardhshme, duke synuar përforcimin e mëtejshëm të kapaciteteve akademike dhe kërkimore të programit.</i></p> <p><i>Evidenca: 2.10 Cv të stafit; Ev. Aneks Tabelat Përmbledhëse - Tabela 6: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë në UT ka në funksion një sistem të institucionalizuar për vlerësimin dhe përmirësimin periodik të metodave të mësimdhënies, ku përfshihen aktivisht edhe studentët. Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse akademike si Senati i UT, Komisioni i Etikës dhe komisionet e përhershme, si dhe në strukturat për sigurimin e cilësisë (NJSBC), në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës. Përveç përfaqësimit formal, feedback-u i studentëve sigurohet përmes</p>

<p>duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>pyetësorëve semestralë që vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen e lëndës, metodat e përdorura, si dhe performancën dhe ndërveprimin e pedagogëve. Rezultatet e këtyre pyetësorëve përpunohen nga NjSBC dhe analizat përkatëse i dërgohen strukturave drejtuese të fakultetit, të cilat ndërmarrin veprime korigjuese apo përmirësuese kur është e nevojshme.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.1 Statuti i UT; Ev. 1.2 Rregullore e UT; Ev. 8.1 UT Manual Vleresimit Personelit; Ev. 12.3 FE Aktiviteti i NJSBC; Ev. 12.3.3: FE Plani i Veprimtarise NJSBC 2024-2025; Ev. 17.3 FE Pyetsor vlerësimi i lëndës nga studenti; Ev. 17.4 FE Pyetsor vlerësimi për pedagogun nga studenti; Ev. 21.2: Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>FE ka ngritur dhe funksionalizon struktura të dedikuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Në nivel fakulteti, Zëvendësdekani për Sigurimin e Cilësisë, Kërkimin Shkencor dhe Marrëdhëniet me Jashtë është personi përgjegjës për koordinimin e politikave të cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), funksionon në përputhje me Rregulloren e UT-së dhe ndjek një plan veprimi të strukturuar, i cili përfshin monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, shërbimeve për studentët, kërkimit shkencor dhe performancës së stafit. NjSBC ushtron funksionin e saj në bashkëpunim të ngushtë me dekanatin dhe departamentet përkatëse. Ndjek periodikisht përgatitjen e syllabuseve dhe dokumentacionit të programit, duke siguruar përputhshmërinë me standardet akademike dhe promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm në përmbajtje dhe metodologji. Për programin Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare", përgjegjësi i departamentit ndjek nga afër realizimin e komponentëve mësimorë dhe adreson çështjet operationale në përputhje me Rregulloren e programit. UT gjashtu ka hartuar strategji zhvillimi që synojnë integrimin e kulturës së cilësisë në të gjitha nivelet, përfshirë edhe promovimin e metodave inovative të mësimdhënies. Personeli akademik shprehet se ka autonomi në përzgjedhjen e metodave dhe hartimin e përmbajtjes mësimore dhe inkurajohet të eksperimentojë me praktika të reja didaktike për të rritur efektivitetin e procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.2: Rregullore e UT; Ev. 1.3 Strategjia e Zhvillimit te UT_2023-2028; Ev. 1.21 Rregullore e Njesisë së</i></p>

	<i>Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin përkatës dhe vizitën institucionale, programi Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare" demonstroi përputhje të mirë me kërkesat standarde lidhur me mësimdhënien, përfshirjen e studentëve dhe zhvillimin profesional të stafit. Struktura të qarta dhe funksionale si NJSBC, përfshirja aktive e studentëve në vlerësim, si dhe përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies, garantojnë një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të cilësisë. Rekomandohet që të vijojë rritja e kapaciteteve të stafit akademik dhe fuqizimi i komponentëve praktikë e kërkimorë brenda programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare" zbaton një qasje të strukturuar dhe të dokumentuar për vlerësimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Kriteret dhe mënyrat e vlerësimit përcaktohen qartë në Rregulloren e Universitetit të Tiranës, Rregulloren e Programit të Studimit, si dhe në syllabuset përkatëse të lëndëve. Në përputhje me kërkesat institucionale dhe legislative, këto dokumente bëhen të njohura për studentët që në fillim të çdo lënde, ku lektori prezanton qartë përmbajtjen e kursit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe peshën specifike të komponentëve të vlerësimit. Kjo praktikë siguron transparencë, parashikueshmëri dhe barazi në trajtimin e studentëve në procesin e vlerësimit akademik. <i>Referenca: Ev. 1.2 Rregullore e UT; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive	Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare", çdo pedagog informon studentët, që në orën e parë të zhvillimit të lëndës, mbi përmbajtjen e saj, objektivat mësimorë, ngarkesën akademike, si dhe metodologjinë e ndjekur për testimin dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive, gjë që u konfirmua edhe në takimin e zhvilluar në institucion me studentët.

<p>profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Këto informacione janë të dokumentuara në mënyrë të qartë dhe të strukturuar në syllabuset përkatëse të lëndëve, ku përfshihen gjithashtu kriteret e vlerësimit, format e ndërveprimit në procesin mësimor, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe literatura përkatëse. Kjo praktikë kontribuon në transparencën e procesit mësimor dhe vlerësues, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve mbi kërkesat dhe objektivat e secilës lëndë.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ</i></p>													
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në përputhje me parimet e përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit MSHSZ dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë ka adoptuar një sistem të testimit dhe vlerësimit të diversifikuar dhe të vazhdueshëm që i jep mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë programit. Format i vlerësimit përfshin një kombinim të elementeve të ndryshëm të vlerësimit, të cilat përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrat e kursit dhe projektet (individuale ose në grup) • Raste studimi • Provime të pjeshme • Provimi përfundimtar <p>Në syllabus-in e secilës lëndë, përcaktohet me saktësi pesha e këtyre komponentëve të vlerësimit, që shpesh ndahen si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="564 1214 1401 1617"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Format e kontrollit të njohurive</th> <th>Programi i Studimit Master Shkencor në Statistika Zyrtare</th> </tr> <tr> <th>Pjesa (në %) ndaj totalit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>0% - 20 %</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)</td> <td>0 % - 50 %</td> </tr> <tr> <td>Testimet gjatë vitit</td> <td>0 % - 30 %</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>30 % - 70 %</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>100%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ky sistem i vlerësimit i jep mundësinë studentëve të shfaqin jo vetëm njohuritë teorike të fituara, por edhe aftësitë praktike dhe analitike, përmes detyrave praktike dhe projekteve, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë një kuptim më të thellë dhe më të aplikuar të materialeve të trajtuara.</p>	Format e kontrollit të njohurive	Programi i Studimit Master Shkencor në Statistika Zyrtare	Pjesa (në %) ndaj totalit	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	0% - 20 %	Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	0 % - 50 %	Testimet gjatë vitit	0 % - 30 %	Provimi përfundimtar	30 % - 70 %	Në total	100%
Format e kontrollit të njohurive	Programi i Studimit Master Shkencor në Statistika Zyrtare													
	Pjesa (në %) ndaj totalit													
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	0% - 20 %													
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	0 % - 50 %													
Testimet gjatë vitit	0 % - 30 %													
Provimi përfundimtar	30 % - 70 %													
Në total	100%													

	<i>Referenca: 1.2 Rregullore e UT; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 03: Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Ev. Aneks Tabelat Përmbledhëse Tabela 15: Format e kontrollit të njohurive</i>			
Konkluzione	<i>Në përputhje me aktet rregullatore të institucionit, procesi i vlerësimit është i strukturuar dhe i dokumentuar në mënyrë transparente dhe të aksesueshme për studentët. Kjo qasje siguron një sistem të diversifikuar vlerësimi, i cili përfshin komponentë të ndryshëm, duke u mundësuar studentëve të demonstrojnë jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësitë praktike dhe analitike të fituara gjatë kursit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare" ka implementuar një qasje të balancuar dhe të dokumentuar për testimin dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive të studentëve gjatë gjithë vitit akademik, siç përcaktohet në Rregulloren e Universitetit të Tiranës dhe syllabuset përkatëse të lëndëve. Sipas këtij sistemi të kombinuar, vlerësimi përfshin komponentë të ndryshëm, si provimet e ndërmjetme, kuize, projekte, detyra individuale dhe në grup, si dhe provimin përfundimtar, të cilat kontribuojnë në formimin e pikëve përfundimtare të studentit. Ky proces vlerësimi ka si qëllim të balancojë përvetësimin teorik dhe zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, duke i mundësuar atyre të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat në mënyrë të plotë dhe të integruar.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.2 Rregullore e UT; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Ev. Aneks Tabelat Përmbledhëse Tabela 14</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për programin e studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare", Fakulteti i Ekonomisë ka implementuar masa të qarta për të rritur transparencën dhe për të shmangur çdo mundësi abuzimi gjatë procesit të testimit dhe vlerësimit. Forma kryesore e provimeve përfundimtare është me shkrim, duke garantuar objektivitetin dhe paanshmërinë në vlerësim. Fletoret e

	<p>provimeve sekretohen dhe ky proces menaxhohet nga personel ndihmës akademik i caktuar nga përgjegjësi i departamentit përkatës, duke u siguruar që provimi të zhvillohet në kushte të mbrojtura. Për më tepër, Fakulteti i Ekonomisë ka bashkëpunuar me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) për të zbatuar projektin "Clean Score", që mundëson korrigjimin automatik të provimeve me alternativa, një hap i rëndësishëm në drejtim të rritjes së transparencës dhe cilësisë së vlerësimit. Megjithatë, për programin e studimit "Statistika Zyrtare", kjo formë e vlerësimit automatik nuk aplikohet për shkak të natyrës së lëndëve, të cilat kërkojnë vlerësime analitike dhe interpretim të thelluar që nuk mund të trajtohen përmes platformave automatike.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.2 Rregullore e UT, Neni 59, Zhvillimi i Provimit; Ev. 11.18 Përdorimi i CleanScore-DSIZ</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për programin e studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare", vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin e secilës lëndë dhe me bazën ligjore të përcaktuar nga Rregullorja e UT dhe Rregullorja e Programit të Studimit. Sipas këtyre rregulloreve, provimi përfundimtar duhet të vlerësohet nga dy pedagogë të lëndës, ku të paktën njëri duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë, për të garantuar një nivel të lartë të objektivitetit dhe drejtësisë. Për të siguruar që provimi mbulon gjithë spektrin e njohurive të nevojshme, teza e provimit hartohet nga lektorët e lëndës dhe miratohet nga Drejtuesi i Departamentit, para se të administrohet. Ky proces siguron që vlerësimi të jetë i balancuar, objektiv dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe akademike.</p> <p><i>Referenca: : Ev. 1.2 Rregullore e UT, Neni 58, Provimi; Neni 59, Zhvillimi i Provimit; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare", vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente dhe feedback të detajuar nga pedagogët, të cilat janë të rëndësishme për orientimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të studentëve. Ky proces përfshin komentet konstruktive gjatë detyrave të kursit, prezantimeve dhe provimeve përfundimtare, që ndihmojnë studentët të kuptojnë ecurinë e tyre dhe të identifikojnë fushat ku duhet të përmirësohen. Pas provimit përfundimtar, studentët mund të shohin fletën e provimit të tyre</p>

	<p>dhe të marrin sqarimet përkatëse, duke siguruar transparencë dhe mundësi për mësim të mëtejshëm. Kjo metodë e vlerësimit përmbush kërkesat e Rregullores së UT, e cila parashikon që komisioni i provimit të shpallë rezultatet brenda 10 ditëve pune dhe të ofrojë mundësinë për rishikimin e provimit.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.2 Rregullore e UT, Neni 60 Vlerësimi përfundimtar; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”, plagjiatura dhe kopjimi janë të ndaluara dhe monitorohen me rigorozitet, sipas Rregullores së UT dhe Kodit të Etikës. Njësitë përgjegjëse, si dhe stafi akademik, zbatojnë masat për të shmangur dhe ndaluar çdo formë të këtyre shkeljeve gjatë provimeve dhe detyrave. Pjesë e kësaj është ndarja e stafit mbikëqyrës gjatë provimeve, ku çdo sallë ka të paktën dy mbikëqyrës, si dhe kontrolli i detajuar i punimeve të diplomës, ku çdo student duhet të plotësojë një formular vetëdeklarimi që garanton origjinalitetin e punimit.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.2 Rregullore e UT, Neni 59, Zhvillimi i provimit; Ev. 1.4 Kodi Etikës UT; Ev. 13 Rregullore e UT për diplomimin</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve janë të bazuara në meritë dhe përputhen plotësisht me rregulloret përkatëse të Universitetit të Tiranës dhe rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi përfundimtar i studentëve përfshin kombinimin e pikëve të marra nga provimi përfundimtar dhe vlerësimi i vazhdueshëm, duke siguruar transparencë dhe objektivitet në procesin e vlerësimit. Rezultatet shpallen në sistemin e-student brenda 10 ditëve pune dhe studentët kanë mundësinë të paraqesin ankesa brenda 48 orëve pas shpalljes, duke siguruar kështu mundësinë e rishikimit dhe transparencës të plotë në procesin e vlerësimit.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.2: Rregullore e UT, Neni 60 Vlerësimi përfundimtar; Ev. 03: Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Ev. 2.7: Syllabuset e lëndëve; Ev. 11.10: UT Manual Sistemi e-student</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të</p>	<p>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikimin e tij në përputhje me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara. Sipas Rregullores së Universitetit të Tiranës dhe rregullorës së programit të studimit,</p>

<p>vlerësimin në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>studentët kanë të drejtë të ankimojnë vlerësimin brenda 48 orëve nga publikimi i tij në sistemin e-student. Procedura e ankimit është e qartë dhe mund të realizohet drejtpërdrejt në sistemin e-student ose me shkrim tek drejtuesi i njësisë përkatëse. Për të garantuar transparencën, studentët mund të kërkojnë një kopje të tezës së zgjidhur dhe mund të kërkojnë ngritjen e një komisioni rivlerësimi, i cili ka për detyrë të verifikojë dhe të përcaktojë vlerësimin përfundimtar. E gjithë kjo procedurë ruhet dhe dokumentohet për qëllime auditimi dhe transparence.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.2: Rregullore e UT, neni 62, Ankimimi për vlerësimin përfundimtar; Ev. 11.2: Përdorues të SIM Print screen; Ev. 11.10: UT Manual Sistemi e-student; Ev. 11.11: UT Manual për pedagog e-student</i></p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Çdo kërkesë ose ankim që shqyrtohet nga Komisioni i Rivlerësimit dokumentohet dhe arkivohet në departamentin përkatës nga personeli ndihmës akademik, duke siguruar transparencë dhe ndjekje të saktë të procedurave. Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB si dhe vizitës në institucion, u konfirmua që për programin e studimit Master Shkencor në "Statistika Zyrtare", nuk ka pasur raste ankimi që janë shqyrtuar nga Komisioni i Rivlerësimit. Procedurat e ndjekura për shqyrtimin e ankeseve janë të dokumentuara dhe ruhet e gjithë informacioni për qëllime auditimi dhe transparencë.</p> <p><i>Referenca: Ev. 1.2: Rregullore e UT, neni 62, Ankimimi për vlerësimin përfundimtar</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare" implementon një sistem të balancuar dhe transparent për vlerësimin e studentëve, duke përfshirë një kombinim të provimeve, projekteve dhe vlerësimeve të vazhdueshme, të cilat sigurojnë objektivitet dhe përputhshmëri me rregulloret e institucionit. Procesi i vlerësimit është i mbështetur në komente dhe feedback konstruktive, ndërsa garanton mundësinë e ankimit dhe rivlerësimit në përputhje me procedurat ligjore dhe akademike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në "Statistika Zyrtare" garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve, duke ofruar një përmbajtje teorike dhe praktike të pasur. Ky program është i strukturuar në përputhje me rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset përkatëse, duke u mundësuar studentëve të zhvillojnë aftësi të avancuara analitike dhe profesionale. Pjesëmarrësit e programit përfitojnë mundësi të shumta për t'u angazhuar në aktivitete praktike, siç janë praktikat profesionale, leksionet e hapura, projektet dhe konferencat të organizuara në bashkëpunim me INSTAT dhe institucione të tjera, të cilat ndihmojnë në përvetësimin e aftësive të nevojshme për një karrierë të suksesshme në fushën e statistikës zyrtare. Për një periudhë të plotë studimi, studenti shpenzon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1200 orë në auditor, ku zhvillohen leksione, diskutime, seminare dhe aktivitete të tjera mësimore që synojnë të zhvillojnë njohuritë teorike dhe analitike të studentëve. • 1800 orë jashtë auditorit, ku studenti angazhohet në aktivitete praktike si punë kërkimore, projekte, praktika profesionale, përgatitje për provime, dhe aktivitete të tjera që kontribuojnë në zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve. <p>Ky angazhim i ndarë midis orëve të leksioneve dhe aktiviteteve jashtë auditorit është një element kyç për zhvillimin e aftësive të studentëve, duke i mundësuar atyre të zbatojnë teorinë në situata reale dhe të përgatiten për sfidat që do të hasin në fushën e statistikës zyrtare.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.5 Marrëveshja e bashkëpunimit me INSTAT; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 2.8 Plan mësimor 2022-2025; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Ev. 10.2 Aktivitetet dhe njoftimet nga Zyra e Karrierës; Ev. 22.2 & 22.3 Marrëveshjet institucionale për praktikat profesionale</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit,</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në "Statistika Zyrtare" është i dizajnuar për të zhvilluar aftësitë e studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit, analizës së të dhënave dhe komunikimit shkencor. Ky program, i ofruar nga Departamenti i</p>

<p>humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, synon përgatitjen e specialistëve që janë të aftë të përpunojnë dhe analizojnë të dhëna statistikore, përfshirë ato sociale, demografike dhe ekonomike, si dhe të paraqesin rezultatet për palët e interesuara, si agjencitë qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare. Për zhvillimin e aftësive të veçanta, programi ofron përdorimin e teknologjisë së informacionit: Studentët janë të trajnuar në përdorimin e softuerëve statistikore, siç janë R, SPSS, STATA, dhe Excel, që janë thelbësore për përpunimin dhe analizimin e të dhënave. Ky trajnim i mundëson studentëve të zbatojnë teknikat statistikore në mënyrë efikase, duke i përgatitur ata për të punuar me sisteme të avancuara të informacionit dhe për të mbështetur analizat e të dhënave të llojeve të ndryshme. Zhvillimin e aftësive humane dhe sociale: Programi përfshin lëndë dhe projekte që nxisin bashkëpunimin dhe ndërveprimin, si dhe komunikimin efektiv mes studentëve dhe stafit akademik. Kjo ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për punën në ekip dhe menaxhimin e projekteve. Komunikimi dhe ndërveprimi në gjuhë të huaj: Përveç përdorimit të literaturës të botuar në gjuhë të huaj, studentët janë inkurajuar të lexojnë dhe konsultohen me burime ndërkombëtare që përmbajnë koncepte të avancuara dhe teknika moderne në fushën e statistikës zyrtare.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.0 Propozimi i programit Master Shkencor në Statistika Zyrtare; Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 2.8 Plani mësimor MSHSZ</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në përputhje me rregulloret e brendshme të institucionit dhe me syllabuset e lëndëve që përbëjnë kurrikulën e programit të studimit, lektorët sigurojnë një proces të qartë dhe transparent të informimit dhe orientimit të studentëve që në fillim të semestrit. Gjatë javës së parë të zhvillimit të lëndës, lektori prezanton për studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivat e lëndës, • Kompetencat dhe aftësitë që pritet të fitohen gjatë kursit, • Detyrimet dhe përgjegjësitë që ka studenti në ndjekjen e rregullt të procesit mësimor, • Si dhe metodologjinë e vlerësimit dhe format e testimit të njohurive, në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit <p>Për secilën lëndë janë të parashikuara edhe orë seminari, të cilat shërbejnë si hapësira bashkëpunuese ndërmjet pedagogut dhe studentëve për të diskutuar mbi ecurinë e përvetësimit të njohurive,</p>



	<p>për të identifikuar vështirësitë e hasura dhe për të orientuar studentët drejt përmirësimit të vazhdueshëm të performancës akademike.</p> <p>Në përfundim të semestrit, gjatë orës së fundit të leksioneve, lektori realizon një përmbledhje të njohurive kryesore të fituara nga studentët, duke dhënë udhëzime për strukturën, natyrën dhe përmbajtjen e provimit final. Në këtë fazë sqarohet gjithashtu pesha e secilit komponent të vlerësimit në notën përfundimtare, në përputhje me Syllabuset e Lëndëve. Gjithashtu, lektori informon studentët mbi të drejtën për t'u paraqitur në provim, duke iu komunikuar pikët e fituara nga format e kontrollit të vazhdueshëm, në zbatim të Rregullores së Programit të Studimit.</p> <p><i>Referenca: Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 2.8 Plani mësimor; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Procesi mësimor në programin e studimit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare" realizohet nga stafi akademik mbi bazë kompetencash të përcaktuara në syllabuset e lëndëve dhe në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit. Që në javën e parë të zhvillimit të lëndës, lektorët prezantojnë për studentët objektivat e lëndës, aftësitë dhe kompetencat që pritet të fitojnë gjatë procesit mësimor, si dhe detyrimet dhe format e vlerësimit. Stafi akademik mbështet zhvillimin e aftësive profesionale dhe analitike përmes përfshirjes aktive të studentëve në diskutime, punë në grup dhe detyra praktike. Në kuadër të lëndëve të planit mësimor, studentët punojnë në grupe për zgjidhjen e problemeve që lidhen me analiza statistikore, vlerësimin e cilësisë së statistikave zyrtare dhe aplikime praktike të metodave të statistikës. Për të mbështetur zhvillimin kërkimor dhe inovativ, stafi akademik inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete shkencore si: Konferenca Studentore, Workshope dhe trajnime të specializuara, si dhe projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Fakulteti i Ekonomisë (FE) mbështet ndërthurjen e formave të mësimdhënies me institucione partnere brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të marrëveshjeve bashkëpunuese. Këto partneritete përfshijnë universitete perëndimore, institucione kërkimore, kompani dhe biznese, të cilat kontribuojnë në pasurimin e përvojës akademike dhe në orientimin praktik të njohurive të fituara nga studentët. Nëpërmjet programeve të mobilitetit ERASMUS+, si dhe përfshirjes në projekte institucionale të UT dhe FE, studentëve dhe stafit u mundësohet</p>

	<p>shkëmbim përvojash akademike me universitete homologe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca: Ev. 2.7 Syllabuset e lëndëve; Ev. 03 Rregullore e Programit të Studimit; Ev. 10.4.4 DSIZ Mobilitete studentë; Ev. 10.5 Web Lajmërimi Bursa Programi ERASMUS+ FEUT; Ev. 20.13 FE Workshop-e; Ev. 20.17 Programi i Konferencës Shkencore Studentore</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni shoqëruar i RVB, konstatohet se Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ), përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” (MSHSZ), ka zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme leksione të hapura, seminare dhe workshope me pjesëmarrjen e lektorëve të huaj dhe vendas, të cilët sjellin në auditor zhvillimet më të fundit të shkencës dhe teknologjisë në fushën e statistikës dhe informatikës së zbatuar. Këto aktivitete janë realizuar si pjesë e projekteve kërkimore-shkencore ku stafi akademik i DSIZ është aktivisht i angazhuar. Përmes tyre, studentëve u është ofruar mundësia të njihen me praktika bashkëkohore, metoda të reja analitike, si dhe me tendencat ndërkombëtare në fushën e statistikës zyrtare dhe të teknologjisë së informacionit. Departamenti ka ndjekur një politikë të qëndrueshme për përfshirjen e ekspertizës ndërkombëtare, duke ftuar pedagogë nga institucione akademike partnere brenda dhe jashtë vendit. Një shembull konkret është bashkëpunimi me Universitetin Linnaeus, ku janë realizuar vizita të ndërsjella të stafit akademik dhe workshope tematike mbi zhvillime të reja në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Aktiviteti kërkimor i stafit të DSIZ dokumentohet dhe raportohet rregullisht çdo vit akademik, nëpërmjet raporteve vjetore të departamentit dhe raporteve të punës kërkimore-shkencore, të cilat dëshmojnë për përfshirjen aktive të stafit në konferenca, botime dhe projekte shkencore.</p> <p><i>Evidenca: Ev. 20.12 FE Leksione të hapura; Ev. 20.13 FE Workshope; Ev. 20.14 DSIZ Workshope; Ev. 20.15 Vizitat e pedagogëve të Linnaeus dhe të stafit të DSIZ në Linnaeus; Ev. 21.3.2 DSIZ Raportim Vjetor; Ev. 21.4.1 DSIZ Raport Puna kërkimore-shkencore</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura</p>	<p>UT, në kuadër të politikave të tij institucionale për nxitjen e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e ideve inovative, organizon në mënyrë periodike konferenca shkencore ndërkombëtare dhe</p>

<p>kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>kombëtare me pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit akademik. Në këtë kuadër, FE, si pjesë e UT-së dhe ofrues i programit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”, inkurajon dhe mbështet angazhimin kërkimor të studentëve përmes përfshirjes së tyre në aktivitete shkencore, projekte dhe konferenca. Në 2024, UT organizoi në ambientet e FE Konferencën e Dytë Studentore Shkencore Ndërkombëtare “Kërkimi shkencor dhe edukimi në perspektivën e studentëve dhe të studiuesve të rinj - UT flet me zërin e studentëve”. Në këtë aktivitet, studentët e programeve të ndryshme të ciklit të dytë, përfshirë edhe ata të programit MSHSZ, prezantuan punime kërkimore të zhvilluara në bashkëpunim me stafin akademik, duke kontribuar në krijimin e një kulture kërkimore aktive dhe bashkëpunuese. Përveç pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore, FE mbështet financiarisht studentët ekselentë përmes bursave dhe u ofron orientim për aplikimin në programet e mobilitetit ndërkombëtar ERASMUS+, në bashkëpunim me universitetet partnere të UT-së. Të gjitha njoftimet për bursa, mobilitete dhe mundësi pjesëmarrjeje në projekte kërkimore publikohen në faqen zyrtare të fakultetit, duke garantuar transparencë dhe akses të barabartë për studentët.</p> <p><i>Referenca: Ev. 10.5 Web Lajmërimi Bursa Programi ERASMUS+ FEUT; Ev. 20.17 - Programi i Konferencës Shkencore Studentore</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” garanton një formim të thelluar akademik dhe profesional, duke ndërthurur mësimdhënien teorike me përvojën praktike dhe kërkimore. Aktivitetet akademike, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe mbështetja institucionale për kërkimin shkencor dhe idetë inovative dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm të departamentit dhe fakultetit për rritjen e cilësisë së formimit të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për</p>	<p>Procedurat e përfundimit të studimeve në programet e ciklit të dytë “Master Shkencor” janë të rregulluara nga aktet normative të</p>

<p>detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Universitetit të Tiranës, përkatësisht nga dispozitat e Rregullores së UT (nenet 67–69), si dhe nga Rregullorja e diplomimit për programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, përfshirë dhe Masterin Ekzekutiv (nenet 7–11). Po ashtu, referenca të detajuara mbi mënyrën e përmbylljes së studimeve gjenden në Rregulloren e programit të studimit Master Shkencor në “Statistika Zyrtare” neni 19.</p> <p>Këto dokumente përcaktojnë kriteret, afatet dhe mënyrën e realizimit të punimit përfundimtar të diplomës, si komponent kyç i procesit të diplomimit. Studentët njihen me këto procedura përmes dokumenteve rregullatore të disponueshme në departamentet përkatëse të Fakultetit të Ekonomisë, si dhe përmes udhëzimeve të ofruara nga personeli akademik përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit. Zbatimi i rregulloreve përkatëse realizohet në mënyrë të unifikuar nga departamentet që administrojnë programet e studimit dhe nga studentët në përfundim të ciklit, duke siguruar respektimin e standardeve institucionale gjatë gjithë procesit, që nga miratimi i temës dhe përgatitja e punimit shkencor deri në organizimin dhe mbrojtjen publike të tij.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 1.2: Rregullore e UT; Evidenca 03: Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Evidenca 13: UT Rregullore “Për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”</i></p> <p>https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Procedurat për përmbylljen e ciklit të dytë të studimeve “Master Shkencor” janë të përcaktuara në aktet normative të Universitetit të Tiranës, në përputhje me dispozitat e nenit 68 të Rregullores së UT. Sipas këtij kuadri rregullator, përfundimi i studimeve në këtë cikël realizohet përmes hartimit dhe mbrojtjes së punimit të diplomës si komponent akademik dhe kërkimor përmbyllës. Udhëzimet e hollësishme për organizimin e procesit të diplomimit janë të përfshira në Kreun III të Rregullores “Për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve, përfshirë Masterin Ekzekutiv”, ku përcaktohen etapat e procesit nga emërimi i udhëheqësit shkencor dhe miratimi i temës së punimit, deri te kërkesat për etikën në kërkim, formatin e paraqitjes dhe mbrojtjen përfundimtare të tezës. Për studentët e programit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”, Fakulteti i Ekonomisë ka</p>

hartuar dhe shpërndarë Udhëzuesin për përgatitjen e temës së diplomës, ku jepen në mënyrë të strukturuar hapat e punës, kërkesat metodologjike dhe standardet akademike që duhet të ndiqen gjatë përgatitjes së punimit përfundimtar. Procesi i mbrojtjes së diplomës zhvillohet në tre sesione vjetore: dimër, verë dhe vjeshtë, në përputhje me kalendarin akademik dhe afatet e miratuara nga njësia bazë. Në semestrin e tretë, përgjegjësi i departamentit bën shpërndarjen e studentëve tek pedagogët udhëheqës, në bazë të ngarkesës akademike dhe përputhshmërisë midis fushës së specializimit të pedagogut dhe temës së zgjedhur nga studenti. Gjatë gjithë fazës së përgatitjes, pedagogu udhëheqës mbështet studentin në zhvillimin e punimit, duke ofruar konsulencë metodologjike, burime bibliografike, udhëzime mbi strukturën e punimit dhe mënyrën e prezantimit të rezultateve, me qëllim sigurimin e cilësisë akademike dhe respektimin e standardeve të kërkimit shkencor. Anëtarët e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës Zbatuese (DSIZ) kontribuojnë me ekspertizë shtesë akademike, kur kjo kërkohet gjatë procesit të hartimit të punimit, në funksion të mbështetjes profesionale të studentëve. Pasi punimi përfundon, pedagogu udhëheqës vlerëson nëse ai përmbush kërkesat cilësore dhe i jep miratimin studentit për mbrojtje para komisionit të diplomimit. Vlerësimi përfundimtar formalizohet në formularin e vlerësimit të diplomës, i cili përfshin një pikëzim nga 1 (shumë i dobët) deri në 10 (shkëlqyeshëm), të përbërë nga kritere të qarta si: cilësia e paraqitjes së punimit, qartësia e objektiveve, korrektësia metodologjike, analiza sasiore dhe cilësore, origjinaliteti i kontributit, rëndësia teorike dhe praktike e punës, si dhe përdorimi korrekt i referencave shkencore. Vlerësimi total përfshin një maksimum prej 100 pikësh në përputhje me standardet institucionale të UT.

Referenca: Evidenca 1.2: Rregullorja e UT, neni 69, Mbrojtja e Diplomes; Evidenca 2.9.1: Format Mikroteze Master Shkencor; Evidenca 2.9.6: Formulatat Vlerësimi Mikroteza MSHSZ; Evidenca 13: UT Rregullore "Për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve "Master Ekzekutiv".

<https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet>

https://docs.google.com/document/d/1WIHCTcCgO9q6nE4nE9hzLeIWtFuaO6_c/edit?tab=t.0

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare” përfundon me hartimin dhe mbrojtjen e një punimi kërkimor përmbyllës, që zëvendëson provimin final të ciklit të studimeve. Punimi i diplomës konceptohet si një mikrotezë shkencore, e cila reflekton aftësinë e studentit për të zhvilluar një analizë të pavarur mbi një temë që lidhet drejtpërdrejt me fushën e studimit dhe me objektivat e programit. Për përgatitjen e këtij punimi, studentët ndjekin udhëzimet metodologjike të përcaktuara në rregulloren institucionale të diplomimit, duke punuar në bashkëpunim të vazhdueshëm me udhëheqësin akademik të caktuar nga departamenti përkatës. Ky bashkëpunim garanton orientimin shkencor, respektimin e etikës së kërkimit dhe përmbushjen e standardeve akademike të Universitetit të Tiranës në procesin e përmbylljes së studimeve.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 1.2: Rregullorja e UT, neni 67 Përmbyllja e detyrimeve të programit; Evidenca 13: UT Rregullore “Për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”, neni 7 Detyrimet përmbyllëse.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në përputhje me nenin 10 të Rregullores për diplomimin në programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve në Universitetin e Tiranës, përcaktohet se pedagogu udhëheqës i punimit të diplomës duhet të zotërojë të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen akademike të studentit gjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit. Roli i tij konsiston në orientimin e studentit për zgjedhjen e temës, strukturimin e përmbajtjes, zhvillimin e kërkimit dhe përdorimin e metodologjive të përshtatshme shkencore. Gjithashtu, ai ofron mbështetje të vazhdueshme akademike dhe konsulencë profesionale, duke siguruar që puna të përmbushë standardet institucionale të cilësisë dhe kërkesat metodologjike të programit. Pedagogu udhëheqës verifikon përmbajtjen, korrektësinë dhe cilësinë e punimit përpara paraqitjes së tij për mbrojtje, duke e miratuar vetëm nëse ai është i përfunduar dhe në përputhje me udhëzimet e miratuara nga institucioni. Në mënyrë të vazhdueshme, që nga fillimi i vitit të dytë akademik, udhëheqësit akademikë qëndrojnë në kontakt të drejtpërdrejtë me studentët, duke i asistuar jo vetëm në aspektet kërkimore e metodologjike, por edhe në zbatimin e procedurave administrative, respektimin e afateve të dorëzimit dhe përmbushjen e detyrimeve akademike që lidhen me kreditet dhe diplomimin. Ky ndërveprim i strukturuar</p>

	<p>garanton orientim efektiv dhe realizim të suksesshëm të procesit të diplomimit në përputhje me standardet e Universitetit të Tiranës.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 03: Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Evidenca 13: UT Rregullore "Për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve "Master Ekzekutiv", Kreu III, neni 10, Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare" përfitojnë qasje të plotë në të gjitha burimet akademike dhe kërkimore të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë, të cilat mbështesin zhvillimin e veprimtarive mësimore, praktike dhe shkencore. Infrastruktura institucionale përfshin bibliotekën fakultare, laboratorët kompjuterikë të pajisur me programe statistikore bashkëkohore, si dhe një sërë shërbimesh mbështetëse që sigurojnë kushte optimale për kërkim dhe mësimdhënie efektive. Fakulteti garanton përdorimin e mjediseve laboratorike dhe pajisjeve teknologjike për analizimin dhe përpunimin e të dhënave, kryerjen e testeve statistikore dhe matjeve empirike, si dhe zhvillimin e projekteve të lidhura me temat kërkimore apo punimet e diplomës. Këto burime janë të aksesueshme për të gjithë studentët e programit, duke mundësuar integrimin e njohurive teorike me praktikën profesionale. Përveç kësaj, personeli teknik dhe akademik i fakultetit siguron asistencë të vazhdueshme dhe mbështetje të specializuar gjatë realizimit të punës praktike dhe kërkimore, duke kontribuar në rritjen e kompetencave analitike të studentëve dhe në arritjen e objektivave të programit në përputhje me standardet akademike të Universitetit të Tiranës.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 03: Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Evidenca 11.9: FE Infrastruktura Mjediset; Evidenca 11.9.1: Foto të laboratorëve të FEUT</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti i programit Master i Shkencave në "Statistika Zyrtare" dorëzon punimin përfundimtar të mikrotezës në formë të printuar dhe elektronike pranë Sekretarisë së Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara nga fakulteti. Procesi i mbrojtjes së punimit të diplomës zhvillohet përpara një komisioni vlerësues të ngritur me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe të miratuar nga Dekani i</p>

	<p>Fakultetit të Ekonomisë, në përputhje me dispozitat e Rregullores së diplomimit të Universitetit të Tiranës. Komisioni përbëhet nga të paktën tre anëtarë me përvojë akademike në fushën përkatëse, ku si rregull përfshihet edhe udhëheqësi akademik i studentit. Gjatë seancës së mbrojtjes, studenti paraqet përmbajtjen e punimit në mënyrë të strukturuar, profesionale dhe argumentuese, duke demonstruar aftësinë për të analizuar dhe interpretuar rezultatet, si dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të komisionit mbi kontributin shkencor të punës së tij. Vlerësimi përfundimtar përcaktohet nga komisioni, duke marrë në konsideratë edhe vlerësimin paraprak të udhëheqësit akademik, në përputhje me kriteret institucionale të cilësisë dhe sistemin e notimit me shkallë dhjetëshe (1–10). Vendimi për notën përfundimtare është përfundimtar dhe i paankimueshëm, sipas dispozitave të rregullores përkatëse. Rezultati i mbrojtjes regjistrohet zyrtarisht në sistemin elektronik universitar e-Student, në mënyrë të unifikuar me vlerësimet e tjera të përfshira në planin mësimor të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 03: Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Evidenca 13: UT Rregullore “Për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”, Kreu III; Evidenca 11.10: UT Manual sistemi e-student</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në Kreun VI të Rregullores së diplomimit për programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve, përfshirë “Masterin Ekzekutiv”, janë përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurat dhe kriteret institucionale që rregullojnë procesin e pajisjes me diplomë të studentëve që përfundojnë me sukses studimet pranë Universitetit të Tiranës. Sipas këtij kuadri rregullator, çdo student që ka përmbushur të gjitha detyrimet akademike, kërkimore dhe administrative të programit përkatës, ka të drejtën të pajiset me diplomën përfundimtare të lëshuar nga Universiteti i Tiranës. Në rastin e programit të studimit Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare (MSHSZ)”, pas verifikimit të plotë të përmbushjes së kërkesave të diplomimit, studenti përfiton titullin Master Shkencor në “Statistika Zyrtare”, diplomë që lëshohet nga Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës dhe miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Përpara shpërndarjes, çdo diplomë regjistrohet zyrtarisht në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave të Arsimit të Lartë, i cili administrohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), në</p>

	<p>përputhje me kuadrin kombëtar të sigurimit të cilësisë. Lëshimi i diplomës përfundimtare kryhet brenda një periudhe jo më të gjatë se gjashtë muaj nga përfundimi i studimeve. Deri në momentin e pajisjes me diplomë, universiteti u ofron studentëve një vërtetim zyrtar për përfundimin e studimeve, të shoqëruar me fletën e notave. Së bashku me diplomën, studenti pajiset me Suplementin e Diplomës, të përgatitur në gjuhën shqipe dhe angleze, në përputhje me standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Forma, përmbajtja dhe përmbajtja përkthimore e këtij dokumenti janë të përcaktuara në nenin 111 të Statutit të UT dhe nenet 70-72 të Rregullores së UT. Fakulteti i Ekonomisë i UT organizon periodikisht ceremoni solemne diplomimi, në kuadër të njohjes publike të arritjeve akademike të studentëve. Gjithashtu, me kërkesë të studentit, institucioni vë në dispozicion programin e plotë të studimeve të MSHSZ në gjuhën shqipe ose angleze, i cili certifikohet me firmën e Zv. Dekanit për anën mësimore në çdo faqe, duke garantuar autenticitetin e dokumentit akademik.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 1.1: Statuti UT, Evidenca 1.2: Rregullore e UT; Evidenca 2.3.0: Urdhër numër 351 për regjistrimin e formës së diplomës, Evidenca 2.6: Suplement i MSHSZ, Evidenca 2.7: Syllabuset e lëndëve, Evidenca 13: UT Rregullore "Për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve "Master Ekzekutiv", neni 15, Evidenca 14.0: UT Suplement i Diplomës</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Në Fakultetin e Ekonomisë, administrimi dhe arkivimi i dokumentacionit akademik të studentëve kryhet në mënyrë të strukturuar nga Sekretaria Mësimore, në përputhje me rregullat institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi për administrimin e të dhënave arsimore. Sekretaria mësimore mban dhe përditëson një sërë regjistrash zyrtarë, që përfshijnë: regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Këto dokumente përbëjnë bazën e të dhënave zyrtare të studentëve dhe administrohen si në formatin e shkruar (analog), ashtu edhe në formatin elektronik, duke respektuar parimet e integritetit dhe të sigurisë së informacionit. Plotësimi i regjistrave kryhet në mënyrë të kontrolluar, pa lejuar ndërhyrje apo korrigjime të paautorizuara, dhe çdo ndryshim pasqyrohet sipas procedurave të dokumentuara. Regjistrat arkivohen në Arkivin e Shtetit, në përputhje me legjislacionin kombëtar për administrimin e dokumenteve arkivore, ndërsa një</p>

	<p>kopje e certifikuar e barasvlefshme me origjinalin ruhet në mënyrë të përhershme në institucion, në respektim të politikave institucionale për ruajtjen e dokumentacionit arsimor. Sekretaria mësimore është gjithashtu përgjegjëse për përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave personale të studentëve, duke siguruar respektimin e plotë të Ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në Republikën e Shqipërisë dhe të standardeve përkatëse të sigurisë dhe konfidencialitetit.</p> <p><i>Evidenca: Evidenca 1.22: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FEUT</i> https://drive.google.com/file/d/1N0D7yoryibFWGazD27ZS2lqKw-5dFV4g/view</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konkludoi se Institucioni siguron mbështetje të plotë akademike dhe infrastrukturore për studentët, përfshirë akses në laboratorë kompjuterikë, burime bibliotekare dhe asistencë tekniko-akademike gjatë realizimit të projekteve kërkimore dhe punimeve të diplomës. Procesi i mbrojtjes realizohet përpara një komisioni të miratuar sipas procedurave formale, ndërsa vlerësimi i punimit bazohet në kritere të qarta cilësie dhe transparence. Administrimi i dokumentacionit akademik të studentëve kryhet në mënyrë të rregullt nga Sekretaria Mësimore, përmes regjistrave zyrtarë të studentëve, arritjeve akademike dhe diplomave, të cilat ruhen si në formë fizike ashtu edhe elektronike, në përputhje me standardet e sigurisë dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (Ligji nr. 124/2024). Në përfundim, evidencat dokumentojnë se proceset e diplomimit, pajisjes me diplomë dhe administrimit të të dhënave studentore janë të mirëpërcaktuara, transparente dhe në përputhje me standardet institucionale të cilësisë dhe kërkesat e akreditimit kombëtar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

<p>Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter nuk aplikohet			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

53

Standardi IV.1
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret **Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, që mbulon programin, plotëson kërkesat ligjore për kualifikimin akademik. Stafi ka tituj “Profesor i asociuar” dhe “Doktor i Shkencave” në fushën e Statistikës, Ekonomisë, Matematikës dhe Informatikës, në përputhje me natyrën e lëndëve. Stafi akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike janë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	4	0	1	0	4	0
Prof. Asoc.	5	1	2	0	4	1
Dr/Phd	2	3	0	1	1	3
Dr. proc	0	0	0	0	1	0
Msc.	0	2	0	1	0	0
Gjithsej	11	6	3	2	10	4

Fushat e kërkimit të tyre lidhen me analizën statistikore, ekonometrinë dhe zbatimet në politikat publike, duke garantuar standardin e mësimdhënies.

Referenca: Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 6.1, 6.2, 6.3; Evidenca 2.10: Cv të stafit

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv është në përputhje me kuadrin ligjor. Programi mbulohet në mënyrë të balancuar ndërmjet stafit të brendshëm dhe atij të kontraktuar, pa tejkalluar normat e lejuara. Për vitin akademik 2024-2025 ngarkesa e orëve mësimore mbulohet në masën 78% nga stafi akademik efektiv. Kjo u konstatua nga tabelat e paraqitura si edhe nga takimi me stafin akademik dhe përgjegjës të departamentit.

Referenca: Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 12.1, 12.2, 12.3

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë e stafit akademik nëpërmjet kontratave afatgjata dhe mbulimit me sigurime shoqërore e shëndetësore. Evidencat e paraqitura dëshmojnë vazhdimësinë e angazhimit të stafit gjatë gjithë periudhës së akreditimit. Gjithashtu edhe nga vizita në institucion dhe takimi me përgjegjës të departamentit dhe stafin, u konfirmua se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është pothuajse i njëjtë ndër vite.</p> <p><i>Referenca: Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 4,12 Evidenca 21.3.2: DSIZ Raportim vjetor 2022–2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit ndjekin kriteret të qarta dhe transparente, të shpallura publikisht nga universiteti, bazuar në nivelin e kualifikimit dhe përputhshmërinë me nevojat e programit. Kjo siguron përzgjedhjen e stafit me ekspertizën e duhur. Kjo u evidentua edhe nga takimi me stafin akademik dhe përfaqësues nga burimet njërëzore gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 7: UT Manual mbi Punësimimin e Personelit në Universitetin e Tiranës; Evidenca 7.4: Procedure rekrutimi tip Evidenca: 7.6: Njoftim Punesimi Kriteret Buletini Nr.16 datë 25.03.2024;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar një numër të mjaftueshëm personeli ndihmës akademik, i cili mbulon nevojat praktike të programit. Ky staf angazhohet në realizimin e orëve laboratorike dhe asiston në përdorimin e programeve statistikore, që janë elementë të domosdoshëm për formimin profesional të studentëve të Masterit Shkencor në “Statistika Zyrtare”. Gjithashtu, personeli ndihmës është përgjegjës për mirëmbajtjen e laboratorëve kompjuterikë dhe ambienteve të tjera të mësimdhënies, duke garantuar funksionalitet të vazhdueshëm dhe mbështetje teknike për studentët. Ky angazhim siguron që procesi mësimor të zhvillohet në kushte optimale dhe në përputhje me natyrën specifike të programit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 7.1: Organigrama FEUT 2025; Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 2: PAE dhe PAK për DSIZ për tre vitet e fundit.</i></p>




<p>K0riteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni ka në funksion një sistem të mirëorganizuar për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave mbi personelin akademik dhe ndihmës të angazhuar në program. Çdo vit akademik përgatiten lista të detajuara me anëtarët e stafit, përfshirë ngarkesën e tyre mësimore në nivel semestri dhe viti, si dhe përgjegjësitë për lëndët apo modulet që mbulojnë. Gjithashtu, dokumentohen edhe të dhënat mbi personelin ndihmës dhe administrativ. Ky proces i rregullt dokumentimi dhe përditësimi ofron transparencë dhe siguri mbi disponueshmërinë e burimeve njerëzore dhe garanton planifikim të qëndrueshëm për ecurinë e programit gjatë gjithë periudhës së akreditimit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 7.4: Procedure rekrutimi tip; Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 4,12</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, me institucionet statistikore shtetërore dhe me përfaqësues të sektorit publik e privat. Këto marrëveshje u japin studentëve mundësinë të kryejnë praktikën profesionale dhe punimet e diplomës në institucione pritëse, ku udhëhiqen nga personel i kualifikuar dhe me përvojë në fushën e statistikës zyrtare. Ky bashkëpunim institucional siguron instruktimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të studentëve, duke rritur cilësinë e formimit praktik dhe duke lidhur mësimdhënien akademike me aplikimet reale në tregun e punës.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 1.2: Rregullore e UT, neni 67, Përmbyllja e detyrimeve të programit. Evidenca 2.5: Marreveshja feut instat 2018</i></p> <p><i>Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 5</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të</p>	<p>Personeli mbikëqyrës në institucionet pritëse luan një rol aktiv në procesin e praktikave profesionale. Ai ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara, ofron udhëzime për përgatitjen e raporteve përfundimtare dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të rezultateve të praktikës. Ky bashkëpunim i ngushtë</p>

<p>marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>siguron që studentët të zhvillojnë kompetencat e nevojshme profesionale dhe të kuptojnë më mirë lidhjen midis teorisë dhe praktikës. Përfshirja e mbikëqyrësve të jashtëm në procesin e vlerësimit përforcon transparencën dhe besueshmërinë e rezultateve të arritura nga studentët.</p> <p><i>Referenca: Evidenca</i> 2.9.2: <i>Formular miratim praktika mesimore msh Evidenca</i> 2.9.3 <i>Formulari vleresimi studentit praktika mesimore msh Evidenca</i> 2.9.4: <i>Formati-raportit-perfundimtar-te-praktikes-mesimore-msh_1</i> Evidenca 2.9.5: <i>Formulari vleresimi studentit praktikant pedagogu udheheqes msh</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në të dhënat e raportit të brendshëm, tabelave përmbledhëse dhe evidencave të paraqitura, si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit Master Shkencor në "Statistika Zyrtare", mbulohet nga një trupë akademike me kualifikime të përshtatshme dhe përvojë kërkimore në përputhje me natyrën e programit. Ngarkesa mësimore është e shpërndarë në përputhje me kuadrin ligjor dhe qëndrueshmëria e stafit sigurohet përmes kontratave afatgjata dhe mbulimit me sigurime shoqërore e shëndetësore. Procedurat e rekrutimit janë transparente dhe bazohen në kritere të përcaktuara qartë, ndërkohë që personeli ndihmës ofron mbështetjen e nevojshme për zhvillimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës. Institucioni administron dhe përditëson rregullisht të dhënat e stafit dhe angazhimeve të tyre. Gjithashtu, marrëveshjet me institucione të tjera dhe përfaqësues të sektorit publik e privat sigurojnë mbikëqyrje dhe instruktim cilësor për studentët gjatë praktikës profesionale dhe punimit të diplomës. Në përfundim, evidencat tregojnë se programi ka një bazë të fortë burimesh njerëzore, të cilat garantojnë standardin akademik dhe profesional të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Auditorët janë në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar dhe me ndarjen e tyre në grupe mësimore. Hapësirat kanë kapacitetin e nevojshëm për leksione dhe seminare, duke ofruar kushte komode për zhvillimin e procesit mësimor. Gjithashtu, ndarja e mjediseve është bërë në përputhje me natyrën specifike të programit dhe të moduleve, ku kërkohet kombinim i mësimdhënies teorike me ushtrimet praktike.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 03: Rregullore e Programit të Studimit MSHSZ; Evidenca 11.9: FE Infrastruktura Mjediset</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në institucion si dhe nga evidencat e dorëzuara nga grupi i punës, mjediset mësimore janë të pajisura me mjete bashkëkohore të teknologjisë së informacionit dhe pajisje elektronike të nevojshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies. Auditorët dhe laboratorët janë të pajisur me projektorë, kompjuterë, internet me shpejtësi të lartë dhe softuerë ndihmës që mbështesin metodologjitë moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo infrastrukturë krijon mundësi që lëndët të zhvillohen duke përdorur metoda interaktive dhe teknologji digjitale.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 11.9: FE Infrastruktura Mjediset Evidenca 11.16: Orari mësimor MSHSZ</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjithashtu nga vizita e GVJ në institucion si dhe nga evidencat e dorëzuara nga grupi i punës, laboratorët e informatikës dhe statistikes janë të pajisur me aparatura dhe mjete të përshtatshme për të mbështetur kërkesat e moduleve të programit. Këto mjediset ofrojnë studentëve aftësimin e nevojshëm praktik përmes softuerëve profesionalë të analizës statistikore si SPSS, STATA, R dhe Python, të cilët përdoren gjerësisht në industrinë e statistikës dhe kërkimit shkencor. Pajisjet dhe ambientet janë në përputhje me objektivat formues të programit dhe garantojnë integrimin e praktikës me teorinë.</p>

	<p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 11.9: FE Infrastruktura Mjediset</i> <i>Evidenca 11.9.1: Foto të laboratoreve të FEUT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni siguron një laborator të teknologjisë së informacionit të pajisur me programe profesionale të përshtatura për natyrën e programit. Laboratori është i pajisur me kompjuterë modernë dhe me licenca për softuerë statistikore, që mbështesin zhvillimin e lëndëve praktike dhe punëve kërkimore të studentëve. Studentët kanë qasje të rregullt dhe të kontrolluar në këtë laborator, gjë që u mundëson ushtrime praktike gjatë gjithë procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 2.7: Syllabuset e lendeve</i> <i>Evidenca 11.9: FE Infrastruktura Mjediset</i> <i>Evidenca 21.1: Raporti vjetor FEUT 2022-2023, 202-2024</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Institucioni, përmes kapaciteteve të veta dhe bashkëpunimeve të vendosura me institucione të tjera, garanton mjedise të përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale. Marrëveshjet me INSTAT dhe institucione të tjera statistikore sigurojnë që studentët të kryejnë praktikat në ambiente pune reale, ku mbikëqyren nga ekspertë të fushës. Ky bashkëpunim siguron që studentët të marrin përvojë praktike të drejtpërdrejta dhe të aftësohen për sfidat e tregut të punës. Edhe pse programi nuk është në fushën mjekësore, struktura e bashkëpunimit është e mjaftueshme për të përmbushur natyrën e tij.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 2.5: Marrëveshja FEUT- INSTAT 2018</i> <i>Evidenca Ankes Tabela 5: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese rang Programi; Aneks Tabelat Përmbledhëse- Tabela 7: Stafit akademik për programin e studimit për tre vitet e fundit.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga analiza e mjediseve dhe infrastrukturës, rezulton se institucioni siguron hapësira të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor teorik dhe praktik. Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe softuerë profesionalë që përputhen me kërkesat e programit. Marrëveshjet me institucionet pritëse për praktikën profesionale plotësojnë në mënyrë cilësore formimin e studentëve. Në tërësi, infrastruktura dhe logjistika mbështesin realizimin me cilësi të programit të studimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse që i vihet në dispozicion studentëve është e mjaftueshme, e strukturuar sipas moduleve të programit dhe në përputhje me gjuhën e ofrimit të studimeve. Librat, artikujt dhe manualët janë të qasshme si në format fizik në bibliotekë, ashtu edhe në version digjital përmes platformave online të universitetit. Kjo siguron që studentët të kenë qasje të plotë në materialet e nevojshme gjatë gjithë periudhës së studimeve. Një pjesë e literaturës është përkthyer ose përshtatur për kontekstin shqiptar, ndërsa titujt më bashkëkohorë në gjuhën angleze sigurojnë lidhjen me literaturën dhe praktikën ndërkombëtare. Ky kombinim garanton marrjen e dijeve të nevojshme për arritjen e objektivave formues të programit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 2.7: Syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 03: Rregulloret e Programit të Studimit MSHSZ</i> <i>Evidenca 11.5.1: UT Sherbimet online.</i> <i>Evidenca 11.6.5: Linku i fondit të librave të bibliotekës së FEUT</i> <i>Evidenca 11.6.7: Biblioteka Formular Cobiss</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse raporton rregullisht përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit, duke reflektuar zhvillimet shkencore dhe praktikën bashkëkohore në fushën e statistikës zyrtare. Përditësimi i listës së titujve bëhet çdo vit akademik në bashkëpunim me pedagogët e lëndëve, gjë që garanton një proces të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar. Kjo qasje siguron që studentët të punojnë me tekste që janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, si ato të Eurostat, OECD dhe institucioneve të tjera prestigjioze. Përfshirja e manualeve të reja, artikujve shkencorë dhe raporteve statistikore të botuara së fundmi rrit cilësinë dhe aktualitetin e procesit mësimor.</p>

	<p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 2.7: Syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 11.6.8: Lista e Librave të rinj 2023-2024.</i> <i>Evidenca 11.12: FE Titujt e rinj të librave 2025</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni i vë në dispozicion studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësi të barabarta shfrytëzimi për të gjithë. Biblioteka është e hapur sipas një orari fleksibël, që përkon me nevojat e studentëve gjatë procesit mësimor dhe përtej tij, duke u mundësuar qasje të vazhdueshme në fondin e literaturës. Studentët e programit përfitojnë nga mjedise të qeta dhe të pajisura me hapësira studimi individual dhe në grup, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e projekteve dhe përgatitjen e punimeve kërkimore. Ky organizim siguron shfrytëzim efektiv dhe të barabartë të burimeve nga të gjithë studentët.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 11.5: UT Biblioteka të UT-së, FE</i> <i>Evidenca 11.6.2: FE Biblioteka J. Limprecht</i> <i>Evidenca 11.9: FE Infrastruktura Mjediset</i> <i>Evidenca 11.13.2: FE Informacion per Biblioteken 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e institucionit është e pajisur me fond fizik të mjaftueshëm, që përfshin tekste bazë dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe angleze, libra metodologjikë dhe revista shkencore ndërkombëtare. Ky fond mbulon të gjitha modulet e programit dhe është i përshtatshëm për formimin e plotë të studentëve. Literatura shkencore e disponueshme i ofron studentëve mundësinë për të ndjekur hulumtime të thelluara dhe për të zhvilluar punime me standard akademik të lartë. Revista të indeksuara ndërkombëtarisht u sigurojnë atyre qasje në studime të fundit, duke nxitur aftësitë analitike dhe kërkimore.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 11.5: UT Biblioteka të UT-së, FE</i> <i>Evidenca 11.6.8: Lista e librave te Rinj 2023-2024</i> <i>Evidenca 11.12 FE Titujt e rinj të librave 2025</i> <i>Evidenca 11.13.2: FE Informacion per Biblioteken 2024-2025</i> <i>Evidenca 11.17: Pasurimi me literaturë i bibliotekes, kërkesat DSIZ 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa</p>	<p>Institucioni ka krijuar kushte që studentët të shfrytëzojnë pa pagesë bibliotekat online dhe bazat e të dhënave shkencore. Studentët kanë akses në platforma ndërkombëtare si Springer, Elsevier dhe</p>

<p>pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>JSTOR, që përmbajnë literaturë të specializuar në fushën e statistikës, ekonometrisë dhe shkencave shoqërore. Ky akses u mundëson atyre të punojnë me burime bashkëkohore dhe të kenë të njëjtat mundësi si studentët në universitetet e tjera evropiane. Përdorimi i bibliotekave online rrit ndjeshëm cilësinë e punimeve kërkimore dhe projekteve të masterit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 11.5.1: UT Sherbimet online</i> <i>Evidenca 11.6: UT Biblioteka JSTORE Agreement 2020 IPA countersigned</i> <i>Evidenca 11.6.3: FE Marrëveshjet për bibliotekat online</i> <i>Evidenca 11.6.6: Manual Ulibrary</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me kompjuterë dhe programe kompjuterike që ndihmojnë studentët në shfrytëzimin e fondit digjital dhe online. Pajisjet teknike përfshijnë kompjuterë modernë, printerë, skanerë dhe lidhje të shpejtë interneti, të cilat garantojnë përdorim pa kufizim nga të gjithë studentët. Ky investim teknologjik është realizuar edhe falë projekteve ndërkombëtare ku universiteti ka marrë pjesë, të cilat kanë mundësuar krijimin e laboratorëve të rinj për analizë statistikore dhe kërkime shkencore. Këto laboratorë plotësojnë bibliotekën si një mjedis mbështetës i fuqishëm për procesin mësimor.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 11.13.2- FE Informacion për Bibliotekën 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i bibliotekës është përcaktuar në përputhje me nevojat e studentëve dhe oraret e zhvillimit të mësimi. Ajo ofron shërbim gjatë gjithë ditës dhe orë të zgjatura në periudha provimesh. Kjo qasje fleksibël i mundëson studentëve të shfrytëzojnë hapësirat në mënyrë optimale.</p> <p>Kapacitetet e bibliotekës janë të mjaftueshme për numrin e studentëve të regjistruar në program, ndërsa hapësirat shtesë të krijuara në laboratorët e financuar nga projektet kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë dhe komoditetin e shfrytëzimit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.23: Rregullore e bibliotekës se FEUT</i> <i>Evidenca 11.5 - UT Biblioteka të UT-së, FE</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të</p>	<p>Biblioteka dhe njësia përgjegjëse ndjekin rregullisht cilësinë e fondit fizik dhe atij online, duke monitoruar përditësimet dhe</p>

<p>programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>shkallën e shfrytëzimit. Raportet vjetore evidentojnë numrin e titujve të rinj, kërkesat për literaturë nga pedagogët dhe studentët, si dhe nivelin e përdorimit të sallave të studimit. Përpjekjet për pasurimin e fondit janë efektive dhe të vazhdueshme. Performanca e stafit akademik në integrimin e literaturës së re në planifikimin e mësimin është e dukshme, duke rritur cilësinë e përgatitjes akademike të studentëve. Ky mekanizëm i brendshëm monitorimi rrit transparencën dhe garanton përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca: 11.6.1: FE Biblioteka Plani Strategjik</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përfundim, evidencat tregojnë se programi i studimit Master Shkencor në "Statistika Zyrtare" përmban literaturë të nevojshme, të përditësuar dhe të aksesueshme, si në formë fizike ashtu edhe digjitale. Biblioteka dhe laboratorët e krijuar nga projektet ndërkombëtare sigurojnë kushte optimale për mësimdhënie, kërkim dhe zhvillim profesional. Përdorimi i bibliotekave online dhe mbështetja teknike për studentët rrisin në mënyrë të ndjeshme cilësinë e procesit të mësimnxënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me</p>	<p>Institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit që mbulon të gjithë ciklin e jetës studentore, që nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi ruan dhe administron të dhëna për studentët, përfshirë regjistrimet, ndjekjen e rezultateve akademike, notat, transferimet dhe procedurat e diplomimit. Kjo siguron një</p>

<p>studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>administrim të qartë dhe transparent të informacionit dhe shmang gabimet burokratike.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.22: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FEUT</i> <i>Evidenca 11.5.1: UT Sherbimet online</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Përveç administrimit të të dhënave të studentëve, sistemi menaxhon informacionin mbi personelin akademik, personelin ndihmës, atë administrativ si dhe partnerët e përfshirë në zbatimin e programit. Regjistrat përfshijnë ngarkesat mësimore, orët e punës, kontratat dhe detyrimet e tjera institucionale. Ky mekanizëm garanton që të gjitha të dhënat të ruhen në mënyrë të centralizuar dhe të aksesueshme sipas nevojës.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.26: FE Manuali i Arkivës</i> <i>Evidenca 8.8: UT Shkresa e Rektorit për regjistrim në OCRID</i> <i>Evidenca 8.8.1 - UT Manuali per regjistrim ne ORCID</i> <i>Evidenca 8.9: UT Krijimi i profileve ne Google Scholar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm ofron akses të dedikuar për studentët dhe personelin. Studentët mund të verifikojnë notat, oraret e leksioneve, rezultatet e provimeve dhe dokumentet e tyre personale, ndërsa pedagogët kanë mundësi të menaxhojnë temat e lëndëve, detyrat, vlerësimet dhe procesin e vlerësimit. Ky akses i personalizuar përforcon transparencën dhe ndërveprimin e vazhdueshëm ndërmjet palëve.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 11.2 Përdorues të SIM Print screen</i> <i>Evidenca 11.5.1: UT Sherbimet online</i> <i>Evidenca 11.8: Upgrade i aplikimit software e-Student</i> <i>Evidenca 11.10: Manual-Sistemi-Studentet-Unitir</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit është i integruar me platforma komunikimi dhe module interaktive që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. Përmes platformës online, studentët marrin njoftime mbi oraret, provimet, ndryshimet në planifikim dhe materialet mësimore, ndërsa pedagogët mund të shpërndajnë udhëzime dhe literaturë shtesë. Kjo rrit fleksibilitetin dhe efikasitetin e procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<i>Evidenca 11.5.1: UT Sherbimet online</i> <i>Evidenca 11.15: Komunikimi në Teams</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Ai prodhon raporte individuale për progresin e studentëve, ngarkesën e stafit dhe të dhëna të përditësuara që përdoren nga organet drejtuese të institucionit për vendimmarrje. Raportimet në kohë reale përmirësojnë cilësinë e administrimit dhe lehtësojnë menaxhimin strategjik të programit. <i>Referenca:</i> <i>Evidenca 11.5.1: UT Sherbimet online</i> <i>Evidenca 11.8: Upgrade i aplikimit software e-Student</i> <i>Evidenca 11.10: Manual-Sistemi-Studentet-Unitir</i> <i>Evidenca 11.15: Komunikimi në Teams</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacioni mbi programin e studimit, përfshirë planin mësimor, stafin akademik, veprimtaritë kërkimore dhe lajmet më të fundit, publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit. Këto të dhëna janë të disponueshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, duke siguruar transparencë dhe akses për studentët vendas dhe të huaj. Kjo e rrit dukshmërinë dhe besueshmërinë e programit. <i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, Kreu VI Faqja e internetit dhe posta elektronike</i> https://feut.edu.al/ https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/160-statistika-zyrtare			
Konkluzione	<i>Nga analiza e evidencave dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se institucioni zotëron një sistem të konsoliduar menaxhimi, i cili administron me efektivitet informacionin mbi studentët, stafin dhe aktivitetet e programit. Sistemi siguron akses të personalizuar për përdoruesit, integron platforma komunikimi interaktive dhe mundëson raportime të përditësuara për organet drejtuese. Transparenca përforcohet nga publikimi i informacionit në faqen zyrtare në dy gjuhë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton raport financiar të detajuar për kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Raporti përfshin analizën e shpenzimeve dhe planifikimin e burimeve të nevojshme për të mbështetur programin gjatë një cikli të plotë studimi. Evidencat tregojnë se planifikimi financiar bëhet në mënyrë të rregullt dhe është i përafëruar me nevojat aktuale të programit, duke garantuar mbulim të plotë të kostove bazë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT, Kreu VI, neni 82, Financimi.</i> <i>Evidenca 2.0: Propozimi Master Shkencor në Statistika Zyrtare</i> <i>Evidenca 21.1: Raporti vjetor FEUT 2022-2023, 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit i njësisë bazë përfshin të gjitha zërat kryesorë financiarë: pagesat e stafit akademik dhe ndihmës, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore, kostot e teknologjive mbështetëse, si dhe investimet për bibliotekën dhe aksesin në burimet online. Gjithashtu, plani reflekton përfitimin e granteve vendase e të huaja dhe kontratave të shërbimeve të lidhura me zhvillimin e programit. Kjo qasje e detajuar tregon se financimi është i mirëstrukturuar dhe i orientuar drejt mbështetjes së drejtpërdrejtë të procesit mësimor e kërkimor.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 8.12: FE Projekt Buxhetet 2025-2024-2023</i> <i>Evidenca 11.6.3: Marrëveshjet për bibliotekat online</i> <i>Evidenca 11.12: Titujt e rinj të librave 2025</i> <i>Evidenca 21.1: Raporti vjetor FEUT 2022-2023, 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e</p>	<p>Institucioni zbaton auditime periodike për vlerësimin e gjendjes financiare dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve. Raportet e auditimit tregojnë transparencë dhe ndihmojnë në identifikimin e</p>

<p>financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>zonave që kërkojnë përmirësim, duke garantuar përdorim efikas të burimeve. Kjo praktikë përforcon besueshmërinë e menaxhimit financiar të institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni raporton çdo vit deri në nivelin e njësisë bazë mbi realizimin e buxhetit të miratuar. Raportet vjetore përmbajnë të dhëna të detajuara mbi përdorimin e fondeve në vitin paraardhës dhe nivelin e realizimit të planit financiar. Kjo rrit transparencën dhe i jep mundësi njësisë të programit të marrin masa korrigjuese në kohë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, neni 7,9,54,55</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT, neni 32,33.</i> <i>Evidenca 8.10: FE shpenzime 22-23-24</i> <i>Evidenca 8.11: FE Buxhetet e miratuar 25-24-23-22</i> <i>Evidenca 8.12: FE Projekt Buxhetet 2025-2024-2023</i> <i>Evidenca 8.13/14 Info për grantet 2022-2023, 2023-2024</i> <i>Evidenca 21.1/2: Raporti vjetor FEUT 2022-2023, 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Evidencat tregojnë se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit. Kapacitetet financiare të alokuara janë të mjaftueshme për ecurinë normale të programit, përfshirë pagesat e stafit, mbështetjen e infrastrukturës dhe aktivitetet kërkimore. Në rastet kur lind nevoja për përmirësime të veçanta, institucioni ka treguar gatishmëri për të diversifikuar burimet e financimit përmes granteve, projekteve dhe partneriteteve. Kjo strategji e bën financimin më të qëndrueshëm dhe të pavarur nga burimet e vetme buxhetore.</p> <p><i>Referenca:</i> https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2023/01/VB-53.pdf https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendimi-SA-te-Ut-per-8-.pdf <i>Evidenca 8.11: FE Buxhetet e miratuar 25-24-23-22</i> <i>Evidenca 8.12: FE Projekt Buxhetet 2025-2024-2023</i> <i>Evidenca 21.1/2: Raporti vjetor FEUT 2022-2023, 2023-2024</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shpreh mendimin se institucioni demonstroi një menaxhim financiar të mirëorganizuar dhe të qëndrueshëm për programin e studimit. Raportet financiare, auditimet periodike, planifikimi i</i></p>

	<i>detajuar i shpenzimeve dhe sigurimi i fondeve shtesë nga grante dhe projekte janë elementë që garantojnë funksionimin normal të programit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Evidencat tregojnë se mbështetja financiare është e mjaftueshme për të përballuar sfidat dhe për të mbështetur cilësinë e procesit mësimor e kërkimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka të hartuar dhe zbaton politika e procedura të qarta për pranimin, regjistrimin, ndjekjen dhe diplomimin e studentëve. Procesi mbulon të gjithë ciklin akademik, nga hyrja deri në diplomim, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 dhe aktet e brendshme rregullatore. Evidencat tregojnë se këto procedura janë të dokumentuara dhe të njohura nga studentët. <i>Referenca:</i> <i>Evidenca 01: Ligj nr. 80-2015 Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, Kreu VII Neni 94 Pranimi në ciklin e dytë të studimit; Nenet 4 Vizioni; Neni 5 Misioni; Neni 6 Parimet.</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 03: Rregullorja e programit MSHSZ</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë	Politikat institucionale garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë studentët dhe kandidatët. Në dokumentacion theksohet se parimi i barazisë respektohet në të gjitha hallkat e pranimit,

<p>dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>përparimit, transferimit dhe diplomimit. Ky element rrit transparencën dhe besueshmërinë e procesit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, Kreu VII Neni 94 Pranimi në ciklin e dytë të studimit; Nenet 4 Vizioni; Neni 5 Misioni; Neni 6 Parimet.</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 03: Rregullorja e programit MSHSZ</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Para çdo viti akademik, institucioni publikon kritere të veçanta për pranimin e kandidatëve në program. Këto kritere janë në përputhje me udhëzimet për Maturën Shtetërore dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse. Ky mekanizëm siguron standarde të njëjta kombëtare dhe përputhshmëri me ligjin.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti UT, Neni 94 Pranimi në ciklin e dytë të studimit</i> <i>Evidenca 03: Rregullore e programit të studimit MSHSZ, neni 10</i> <i>Evidenca 18.1: UT Kriteret e pranimit 2024-2025</i> <i>Evidenca 18.1.1/2: Kuotat e studentëve 2023-2024, 2024-2025, 2025-2026</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për pranimin, përparimin, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme dhe diplomimin janë të dokumentuara dhe publikohen në faqen e internetit. Ato janë të kuptueshme, janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të aksesueshme nga publiku, gjë që ndihmon transparencën e procesit. Gjatë vizitës në institucion, takimit me GVB dhe zyrën e Këshillimit të Karrieres, u diskutua se krahas komunikimit dixhital, organizohen edhe takime orientuese me kandidatët, ku shpërndahen materiale informuese që sqarojnë kriteret dhe procesin e pranimit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 18.2.2: UT FE Links për kriteret e pranimit</i> https://feut.edu.al/programe-studimi/master/216-kriteret-e-pranimit-ne-ciklin-e-dyte-te-studimeve-master https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifet-e-studimit/ https://unitir.edu.al/arkiva-2024-2025-kriteret-e-pranimit-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-universitetin-e-tiranes/</p>

	<p>https://feut.edu.al/programe-studimi/master/216-kriteret-e-pranimiit-ne-ciklin-e-dyte-te-studimeve-master https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-statistika-zyrtare</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Para fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe kandidatët e interesuar mbi kriteret dhe kërkesat e programit. Ky informacion bëhet publik përmes faqes së internetit, broshurave dhe udhëzuesve të studentit. Praktika e komunikimit të hershëm është një garanci për qartësi dhe planifikim nga ana e studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 18.2.1: IE Programi i Studimit Booklet</i> <i>Evidenca 20.10: Takime me studentët e viteve të para 2022 dhe 2023</i> https://feut.edu.al/lajmerime/2271-takime-me-studentet-e-vitet-te-pare-dt-02-10-2023</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni ka hartuar kriteret të posaçme për pranimin e studentëve nga grupet vulnerabël, duke përfshirë persona me aftësi të kufizuara, pakica dhe shtresa të marginalizuara. Këto masa reflektojnë angazhimin për gjithëpërfshirje dhe respektim të të drejtave të njeriut.</p> <p>Të gjitha kriteret dhe procedurat janë të qarta, të strukturuar në mënyrë të kuptueshme dhe të aksesueshme për çdo të interesuar, përmes platformave zyrtare të komunikimit të institucionit, përfshirë faqen zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT, neni 39</i> <i>Evidenca 03: Rregullore e programit të studimit MSHSZ</i> https://feut.edu.al/lajmerime/1950-mbi-kriteret-e-pranimiit-te-studenteve-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-fakultetin-e-ekonomise-ut-per-vitin-akademik-2024-2025</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave viet re se për kandidatët nga shtete të tjera, institucioni ka përcaktuar kriteret të posaçme pranimi. Ato publikohen rregullisht dhe përfshijnë kërkesa për njohjen e diplomave dhe verifikimin e dokumentacionit. Kjo e bën programin të hapur dhe tërheqës për studentët ndërkombëtarë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT, neni 39</i></p>

	<p><i>Evidenca 03: Rregullore e programit të studimit MSHSZ</i> https://feut.edu.al/lajmerime/1950-mbi-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-fakultetin-e-ekonomise-ut-per-vitin-akademik-2024-2025</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni ka politika për bursa dhe ndihmë financiare për studentët në nevojë. Përveçse ndihmojnë shtresat vulnerabël, këto politika motivojnë studentët e ekselencës dhe rrisin cilësinë e pranimeve në program. Kjo lidhet edhe me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe prioritetet ekonomike të vendit. Kategoritë përfituese përfshijnë: studentët me aftësi të kufizuara; jetimët; ata që kanë humbur kujdestarinë prindërore; viktimat të trafikut; fëmijët e personave me aftësi të kufizuara; studentët me ndihmë ekonomike; ata me prind të ndjerë; studentët nga komuniteti rom dhe egjiptian; fëmijët e punonjësve të institucioneve të sigurisë që kanë humbur jetën në detyrë; fëmijët e ish-të përndjekurve politikë; si dhe studentët me mesatare 9-10 në ciklin e parë ose vitin e parë të ciklit të dytë. Për të përfituar reduktimin 50% të tarifës, studentët duhet të dorëzojnë dokumentacionin përkatës pranë Degës së Shërbimeve në FE-UT.</p> <p><i>Referenca:</i> https://feut.edu.al/lajmerime/2642-bursa-perjashtim-reduktim-nga-tarifa-e-shkollimit-per-studentet-e-ciklit-te-pare-dhe-te-dyte-per-vitit-akademik-2024-2025 https://docs.google.com/document/d/1Yw7B311GEhgAQBNSKnWoX7AQQ3KY1OCB/edit?tab=t.0</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve, konstatohet se institucioni ka një kuadër të plotë politikash dhe procedurash që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve. Politikat janë transparente, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me legjislacionin. Ato garantojnë trajtim të barabartë, akses të hapur në informacion dhe mbështetje financiare për studentët në nevojë. Përfshirja e kriterëve për studentë ndërkombëtarë e bën programin më tërheqës dhe konkurrues.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve udhëzues të detajuar mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, duke përfshirë kushtet e kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Këto informacione janë të dokumentuara në rregulloret e studimeve dhe janë të aksesueshme online dhe në formë të shtypur, duke garantuar transparencë të plotë për studentët.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT, Neni 63 Kreu V</i> <i>Evidenca 13: Rregullore për diplomim në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve "Master Ekzekutiv", në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 03: Rregullore e programit të studimit MSHSZ</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të rregullt për kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të pjesshme. Procesi është i përcaktuar në dokumentet rregullatore të institucionit dhe bazohet në kuadrin ligjor kombëtar dhe europian për njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve. Për të siguruar orientim të qartë dhe për të lehtësuar aplikimin, të gjitha informacionet në lidhje me kriteret, afatet dhe procedurat e transferimit janë të publikuara dhe të përditësuara rregullisht në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës dhe të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti UT, Neni 109 Transferimet</i> <i>Evidenca 03: Rregullore e programit të studimit MSHSZ</i> https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimet-kuotat-dhe-tarifate-studimit/ https://unitir.edu.al/arkiva-2024-2025-kriteret-e-pranimet-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-universitetin-e-tiranes/ https://unitir.edu.al/per-procedurat-e-pranimet-dhe-te-regjistrimit-ne-universitetin-e-tiranes-per-vitin-akademik-2021-2022-te-kandidateve-qe-aplikojne-per-transferim-te-studimeve-dhe-per-program-te-dyte-studimi-trojet-dh/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të</p>	<p>Institucioni ka procedura të qarta për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve, të cilat komunikohen paraprakisht përmes planeve mësimore dhe syllabuseve të moduleve. Edhe në takimin që GVJ pati me studentët, këta të fundit konfirmojnë se njihen me format e vlerësimit (provime, detyra, projekte, prezantime) dhe me kriteret</p>

<p>studentëve në programin e studimit.</p>	<p>evlerësimit, gjë që garanton transparencë dhe barazi në proces. Në rast të paqartësive apo nevojës për sqarime shtesë, studentët kanë mundësi t'i drejtohen Sekretarisë Mësimore, e cila ofron asistencë të vazhdueshme dhe informacion të saktë mbi të gjitha aspektet e procesit mësimor dhe vlerësues.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti UT</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT, Kreu V, Neni 58, Neni 59, Neni 60</i> <i>Evidenca 03: Rregullore e programit të studimit MSHSZ, kreu IV</i> https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-statistika-zyrtare</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat për përgatitjen e temës së diplomës dhe procesin e diplomimit janë të përcaktuara qartë dhe u komunikohen studentëve në gjysmën e dytë të vitit të dytë akademik. Përpara fillimit të praktikës profesionale, studentët njoftohen në mënyrë zyrtare mbi afatet, procedurat, kriteret për përzgjedhjen e temës së diplomës dhe hapat që duhet të ndjekin deri në mbrojtjen përfundimtare. Ky informacion jepet nga udhëheqësit shkencorë të emëruar dhe Sekretaria Mësimore. Institucioni organizon takime informuese dhe ofron udhëzues të posaçëm për formatin, afatet dhe kriteret e vlerësimit të punimit të diplomës.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti UT, Neni 92</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT, Kreu V Nenet 58-69, Neni 68 Neni 69</i> <i>Evidenca 2.9.1: format_mikroteze_master_shkencor</i> <i>Evidenca 03: Rregullore e programit të studimit MSHSZ, kreu IV</i> <i>Evidenca 13: Rregullore për diplomim në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve "Master Ekzekutiv", në Universitetin e Tiranës</i> https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve</p>	<p>Institucioni, përpara çdo viti akademik, publikon udhëzues të posaçëm mbi programin e studimit dhe organizon takime të hapura me studentë dhe të interesuar. Këto takime shërbejnë për të qartësuar kriteret e pranimit, përparimit, diplomimit dhe veçoritë e programit. Praktika e komunikimit periodik rrit ndërveprimin mes stafit dhe studentëve dhe garanton një proces më të strukturuar informimi.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 18.2.1: IE Programi i Studimit Booklet</i> https://feut.edu.al/programe-studimi</p>

të ardhshëm mbi programin e studimit.	https://feut.edu.al/lajmerime/712-programet-master-qe-ofrohen-ne-fakultetin-e-ekonomise https://feut.edu.al/lajmerime/2238-fillojne-aplikimet-per-studimet-e-ciklit-te-dyte-master-2 https://drive.google.com/file/d/1cXHHRWFyNxt3Zu714rSYTpO5ztC3P_J/view https://drive.google.com/file/d/1TKGv1uUanBcsllYWZGiZAPkS9aaD-g_/view https://drive.google.com/file/d/1l0ni5tjsBIZQnQKvved0wYJsCMtPc-5/view			
Konkluzione	<p><i>Nga analiza rezulton se institucioni siguron një nivel të lartë transparence dhe informimi për studentët e programit. Politikat dhe procedurat e përparimit akademik, njohjes së studimeve, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë të dokumentuara, të aksesueshme dhe komunikohen në mënyrë sistematike. Organizimi i takimeve periodike dhe publikimi i udhëzuesve kontribuon në qartësi dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët informohen qartë dhe në mënyrë të hollësishme mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ky informacion është i përfshirë në udhëzuesin e studentit, rregulloret dhe materialet prezantuese të programit. Studentët kanë akses të vazhdueshëm në këtë dokumentacion, gjë që garanton transparencë dhe ndihmon në planifikimin e rrugëtimit akademik.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti UT, Kreu VII, Nenet 91-94</i> <i>Evidenca 03: Rregullore e programit të studimit MSHSZ, Kreu II</i> <i>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse-Tabela 10</i> <i>Evidenca 20.10: Takime me studentët e viteve të para 2022 dhe 2023</i> https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-statistika-zyrtare </p>

	https://feut.edu.al/lajmerime/2271-takime-me-studentet-e-vitit-te-pare-dt-02-10-2023
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve dokumentacion dhe udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe aktivitetet formuese. Syllabuset e detajuara për secilën lëndë përshkruajnë objektivat, rezultatet e pritshme të të nxënit, metodologjitë e përdorura dhe format e vlerësimit. Ky informacion i plotëson studentët me njohuritë e nevojshme për të ndjekur me sukses procesin mësimor. Përtej komunikimit të drejtpërdrejtë, informacioni i plotë mbi programin e studimit, përfshirë strukturën akademike, përmbajtjen modulare, organizimin semestral, kushtet e pranimit dhe objektivat formues, është në dispozicion të studentëve në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare të internetit të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 18.2.1: IE Programi i Studimit Booklet</i> <i>Evidenca 20.10: Takime me studentët e viteve të para 2022 dhe 2023</i> https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-statistika-zyrtare https://feut.edu.al/lajmerime/2271-takime-me-studentet-e-vitit-te-pare-dt-02-10-2023</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Studentët marrin informacion të rregullt mbi mundësitë e punësimit pas diplomimit, si dhe mbi mbështetjen institucionale për orientim në tregun e punës. Institucioni bashkëpunon me institucione të tjera dhe agjenci statistikore kombëtare dhe ndërkombëtare për të ofruar mundësi praktike dhe për të forcuar lidhjen e studentëve me tregun e punës. Ky element e rrit atraktivitetin e programit dhe siguron qasje praktike për studentët.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 10.1 Raport mbi qëndrën e karrierës</i> <i>Evidenca 10.2: Aktivitetet Njoftimet Web Zyra e karrierës</i> <i>Evidenca 17.5: DSIZ ALUMNI Raport mbi Punësimin - Pyetësori i FE</i> <i>Evidenca 20.0: FE Udhëzim për funksionimin e zyrës së karrierës</i> <i>Evidenca 20.3.2: Këshilli i karrierës Aktivitet FEUT</i> <i>Evidenca 20.11: FE Panairi i punës 2022, 2023, 2024 dhe 2025</i> <i>Evidenca 22.1: Marrëveshjet Ndërinstitucionale mars 2025</i> <i>Evidenca 22.2: Lista e Marrëveshjeve Institucionale Praktikant 2023-2024</i> https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-statistika-zyrtare</p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>https://feut.edu.al/studentet/190-mundesi-punesimi-per-studentet</p> <p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i përditësuar mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse. Ky informacion komunikon oraret, vendndodhjet e mësimit, pajisjet laboratorike dhe mjediset ndihmëse, duke u përshtatur me nevojat e studentëve dhe natyrën e programit. Në fillim të çdo viti akademik, Fakulteti i Ekonomisë, në bashkëpunim me Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, organizon sesione informuese të strukturuar për studentët e sapopranuar në programin Master i Shkencave në “Statistikë Zyrtare”. Gjatë këtyre sesioneve orientuese, studentëve u prezantohet informacion i detajuar lidhur me strukturën akademike të programit të studimit dhe organizimin semestral; planin mësimor, përmbajtjen e lëndëve dhe rezultatet e pritshme të të nxënit; format dhe kriteret e vlerësimit, si dhe kohëzgjatjen e programit; infrastrukturën në dispozicion, përfshirë bibliotekën, labororët, systemin teams dhe ambientet ndihmëse të nevojshme për procesin akademik. Gjatë takimeve, studentët njihen me drejtuesit institucionalë të fakultetit dhe informohen mbi objektivat strategjike të zhvillimit akademik dhe mbështetjen institucionale të ofruar gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.22: FE Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidenca 1.23: FE Rregullore e Bibliotekës</i> <i>Evidenca 10.2: Aktivitetet Njoftimet Web Zyra e karrierës</i> <i>Evidenca 11.15: Komunikim ne teams me MSHSZ</i> <i>Evidenca 20.0: FE Udhëzim për funksionimin e zyrës së karrierës</i> <i>Evidenca 20.10: Takime me studentët e viteve të para 2022 dhe 2023</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni mbi programin e studimit është i integruar në sistemin e brendshëm të menaxhimit dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët, edhe në distancë. Ky sistem garanton komunikim efektiv dhe përdoret për të shpërndarë dokumente, njoftime, plane mësimore dhe rezultate të vlerësimeve.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 11.15: Komunikim ne teams me MSHSZ</i> <i>Evidenca 18.2.1: IE Programi i Studimit Booklet</i> https://feut.edu.al/studentet/61-sherbime-studentore https://feut.edu.al/lajmerime/2271-takime-me-studentet-e-vitit-te-pare-dt-02-10-2023</p>

Konkluzione	<i>Analiza tregon se institucioni siguron një kuadër të plotë informacioni për studentët, duke mbuluar strukturën dhe përmbajtjen e programit, rezultatet e të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Informacioni është i aksesueshëm në forma të ndryshme (udhëzues, syllabuse, platforma online), i përditësuar dhe i përshtatur me nevojat e studentëve. Për më tepër, bashkëpunimi me partnerët e tregut të punës rrit ndikimin praktik të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Institucioni mban dhe përditëson rregullisht statistikën për numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin Master I shkencave në “Statistika Zyrtare”. Të dhënat janë të dokumentuara në sekretarinë mësimore dhe përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe të njësisë së sigurimit të cilësisë. Në RVB janë paraqitur tabela që pasqyrojnë trendin e regjistrimeve, diplomimeve dhe përfundimeve të suksesshme në periudha të ndryshme akademike. Këto evidenca dëshmojnë se programi ruan stabilitet në numrin e studentëve dhe në përfundimin e studimeve brenda afateve.</p> <p><i>Referenca:</i> Evidenca 1.2: Rregullore e UT, neni 94 Evidenca 1.22: FE Rregullore e sekretarisë mësimore Evidenca 18.4: FE të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar të diplomuar (2019-2024)</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo	<p>Përveç statistikave të përgjithshme, institucioni mbledh dhe përditëson të dhëna mbi tërheqjet dhe ndërprerjet e studimeve. Këto të dhëna analizohen në mënyrë periodike nga njësia e sigurimit të cilësisë dhe raportohen në takimet e departamentit, për të identifikuar shkaqet që çojnë në braktisjen e studimeve. Gjatë vizitës në sekretari dhe kontrollit të regjistrave u vu re se për programin në proces, përqindja e largimeve është minimale (më pak se 5%), çka tregon motivim dhe vijueshmëri të lartë të</p>

<p>mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>studentëve. Në raste të veçanta, studentët që ndërpresin studimet rikthehen në periudha të mëvonshme dhe këto raste ndiqen në mënyrë individuale nga sekretaria mësimore.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në tre vitet e fundit akademike janë si më poshtë:</p> <p>2022-2023 13 studentë 2023-2024 0 studentë 2024-2025 15 studentë</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.22: FE Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidenca 18.4: FE të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar të diplomuar (2019-2024)</i> <i>Vizita në sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Universiteti i Tiranës përdor një Sistem të Brendshëm të Menaxhimit të Studentëve (SBMS), i cili ruan të gjitha të dhënat akademike dhe personale të studentëve. Ky sistem ofron mundësinë e qasjes së kontrolluar për personelin e autorizuar (sekretaritë, dekanati, koordinatorët e programeve), duke respektuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Për çdo student ruhet dosja elektronike që përfshin historikun akademik, pjesëmarrjen, rezultatet, dhe të dhënat e diplomimit. Ky sistem përdoret gjithashtu për gjenerimin e statistikave automatike të regjistrimeve dhe diplomimeve për çdo vit akademik.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, Neni 124 Të dhënat e studentëve</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullorja UT, Neni 56 Dokumentacioni i procesit mësimor</i> <i>Evidenca 1.22: FE Rregullore e sekretarisë mësimore</i> https://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe</p>	<p>Institucioni mbështet me akte zyrtare kontrollin periodik pranë njësive përgjegjëse për administrimin e të dhënave të studentëve, si sekretaritë mësimore dhe administrata e programit. Raportet e kontrollit evidentojnë saktësinë e dokumentacionit dhe vlefshmërinë e tij, duke forcuar procesin e monitorimit të brendshëm.</p> <p>Këto kontrolle realizohen të paktën një herë në vit dhe përfshihen në raportin vjetor institucional të cilësisë. Kontrolli i cilësisë dhe saktësisë së informacionit realizohet përmes analizës së rregullt të të dhënave statistikore, që shërbejnë si bazë për vlerësimin e</p>

<p>të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>treguesve të performancës së studentëve, përfshirë: mesataret në hyrje dhe në përfundim të studimeve, normat e diplomimit dhe rastet e mobilitetit horizontal apo braktisjes së studimeve. Për programin Master i Shkencave në “Statistika Zyrtare”, këto statistika përpunohen dhe dokumentohen periodikisht nga Sekretaria Mësimore dhe u nënshtrohen analizave për përmirësim të vazhdueshëm institucional.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.22: FE Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidenca 18.4: FE të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar të diplomuar (2019-2024)</i> <i>Evidenca 1.9: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia bazë përgatit raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Raportet përfshijnë edhe të dhëna mbi shkallën e punësimit pas diplomimit, duke shërbyer si instrument vlerësimi për cilësinë e programit dhe duke orientuar masa për përmirësim të vazhdueshëm. Ky proces lidhet drejtpërdrejt me misionin e programit për të përgatitur specialistë të aftë në fushën e statistikës zyrtare. Ndërkohë, Qendra e Karrierës vlerëson ecurinë e studentëve pas diplomimit, duke analizuar shkallën e punësimit dhe duke hartuar raporte përkatëse sipas përcaktimeve të rregullores së saj. Databaza e ALUMNI shërben edhe si burim i rëndësishëm informacioni për punësimin dhe zhvillimin profesional të studentëve të diplomuar. Kjo databazë zgjerohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 4.2: Studimi i tregut të punës UT 2022</i> <i>Evidenca 17.5: DSIZ ALUMNI Raport mbi Punësimin - Pyetësori i FE</i> <i>Evidenca 20.0: FE Udhëzim për funksionimin e zyrës së karrierës</i> <i>Evidenca 20.3.1: Rreth këshillimit të karrierës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës</i> <i>Evidenca 20.3.2: Këshilli i karrierës Aktivitet FEUT</i> <i>Evidenca 21.1: Raporti vjetror FEUT 2022-2023</i> https://feut.edu.al/studentet/keshillim-i-karrieres/rreth-qendrese-karrieres</p>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka ngritur një sistem të qëndrueshëm dhe efektiv për mbledhjen, administrimin dhe analizimin e të dhënave të studentëve, nga momenti i pranimit deri në përfundimin e studimeve. Statistikat për regjistrimet, diplomimet dhe progresin e studentëve përditësohen rregullisht dhe përdoren në mënyrë analitike për të vlerësuar ecurinë e programit. Të dhënat ruhen në sistemin elektronik institucional, i cili garanton saktësi, transparencë dhe siguri të plotë, ndërsa kontrollet periodike sigurojnë integritetin e informacionit të administruar. Në nivel departamental, analizohen tendencat e regjistrimeve dhe rezultatet e diplomimit, ndërkohë që realizohen edhe anketa për gjurmimin e punësimit të të diplomuarve. Rezultatet tregojnë një normë të lartë punësimi dhe lidhje të fortë midis përmbajtjes së programit dhe kërkesave të tregut të punës. Ky proces reflekton përkushtim të institucioni për menaxhimin e bazuar në të dhëna dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Institucioni ka të përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloret e brendshme mënyrat e përfshirjes së studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Studentët janë pjesë aktive e këshillave të fakultetit, komisioneve të departamentit dhe forumeve të tjera që lidhen me cilësinë e procesit akademik. Kjo strukturë organizative garanton përfaqësim real të studentëve në proceset që ndikojnë drejtpërdrejt në përmbajtjen dhe zhvillimin e programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, Neni 129, Neni 130-134</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT, Kreu VII</i> <i>Evidenca 20.6: UT Rregullore për zgjedhjen e Këshillave të studentëve</i></p>



	https://feut.edu.al/studentet/organizime-studentore/keshilli-i-fakultetit-te-ekonomise-dhe-senati-i-universitetit-te-tiranes-2
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve është reale dhe e matshme, pasi ata marrin pjesë në diskutime, japin rekomandime dhe ndikojnë në vendimet që prekin procesin akademik. Evidencat tregojnë se kontributi i tyre është reflektuar në rishikimin e moduleve dhe përmirësimin e shërbimeve studentore. Kjo tregon një model bashkëpunimi aktiv dhe frytdhënës mes stafit dhe studentëve. Një mekanizëm efektiv për mbledhjen dhe analizimin e mendimeve të studentëve janë pyetësorët periodikë të shpërndarë nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Këta pyetësorë përfshijnë si pyetje të strukturuar, ashtu edhe hapësira për komente të lira, duke u mundësuar studentëve të japin vlerësime të drejtpërdrejta mbi përvojën e tyre akademike. Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe publikohen në faqen zyrtare të universitetit, duke garantuar transparencë dhe akses publik.</p> <p><i>Referenca:</i> https://feut.edu.al/studentet/organizime-studentore/keshilli-i-fakultetit-te-ekonomise-dhe-senati-i-universitetit-te-tiranes-2 https://feut.edu.al/lajmerime/1215-listat-e-zgjedhesve-per-keshillin-studentor-te-fakultetit-te-ekonomise-ut https://feut.edu.al/lajmerime/1214-lista-e-kandidateve-per-keshillin-studentor-te-fakultetit-te-ekonomise-ut https://feut.edu.al/lajmerime/2214-pyetesor-per-t-u-plotesuar-nga-studentet-e-programit-master-viti-akademik-2022-2023 https://feut.edu.al/lajmerime/1408-sondazhi-kombetar-i-studenteve-ascal-zhvillon-takim-informues-me-studentet-e-fe</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin organizon rregullisht mbledhje me studentët dhe përfaqësuesit e tyre, duke mbledhur sugjerime për hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit. Kontributet e studentëve mblidhen edhe përmes pyetësorëve të anonimizuar dhe grupeve të fokusit, të cilat përdoren për të adresuar çështje specifike të cilësisë së mësimdhënies dhe infrastrukturës. Sugjerimet e tyre reflektohen në ndryshimet e bëra në planin mësimor dhe organizimin e veprimtarive praktike.</p> <p><i>Referenca:</i> Evidenca 1.1: Statuti i UT, Neni 132 Evidenca 1.2: Rregullorja UT, Neni 92</p>

	https://feut.edu.al/lajmerime/2214-pyetesor-per-t-u-plotesuar-nga-studentet-e-programit-master-viti-akademik-2022-2023 https://feut.edu.al/lajmerime/1408-sondazhi-kombetar-i-studenteve-ascal-zhvillon-takim-informues-me-studentet-e-fe			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u garantohet e drejta për të shprehur mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit të dijeve. Ata kanë mundësi të ankimojnë rezultatet e provimeve dhe të kërkojnë rishikimin e tyre sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret e institucionit. Kjo praktikë forcon besimin e studentëve në procesin e vlerësimit dhe siguron respektimin e standardeve të drejtësisë akademike. <i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, Neni 6 Parimet</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullorja UT, Neni 61, Neni 62, Neni 65</i> https://unitir.edu.al/manul-perdorimi-sistemi-e-student/ https://feut.edu.al/lajmerime/2214-pyetesor-per-t-u-plotesuar-nga-studentet-e-programit-master-viti-akademik-2022-2023			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ndërtuar një sistem funksional që siguron pjesëmarrje reale dhe efektive të studentëve në proceset akademike dhe vendimmarrëse. Përfaqësimi i tyre në organet institucionale, pjesëmarrja në rishikimin e programeve dhe mundësitë për të dhënë feedback tregojnë se zëri i studentëve merret seriozisht dhe ka ndikim të matshëm në zhvillimin e programit të studimit. Gjithashtu, mekanizmat e ankimimit dhe vlerësimit të drejtë të dijeve janë funksionalë dhe kontribuojnë në krijimin e një mjedisi akademik të drejtë dhe bashkëpunues. Këto elemente pasqyrojnë një kulturë të mirë të përfshirjes studentore dhe përkushtim institucional për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme

Institucioni ka ngritur njësi të posaçme për shërbimin e studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregulloret e veta. Këto

<p>në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>njësi funksionojnë si pika kontakti të drejtpërdrejta ku studentët marrin informacion mbi procedurat akademike, shërbimet dhe mbështetjen që ofrohet gjatë gjithë periudhës së studimeve. Kjo strukturë e dedikuar ndihmon në lehtësimin e komunikimit dhe në zgjidhjen në kohë të problematikave.</p> <p><i>Referenca:</i> https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/?utm_ https://unitir.edu.al/marreveshje-bashkepunimi-universiteti-i-tiranes-me-agjencine-kombetare-te-punesimit-dhe-aftesive/ https://feut.edu.al/studentet/keshillim-i-karrieres/rreth-qendres-se-karrieres?utm</p> <p><i>Evidenca 20.3: Studentët Këshillim karriere, FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit akademik të studentëve. Sistemi përdoret për të asistuar studentët në çështje që lidhen me planifikimin e studimeve, ndjekjen e rezultateve të tyre, si dhe për të adresuar kërkesat apo shqetësimet në lidhje me programin. Ky mekanizëm shërben si mbështetje e vazhdueshme dhe e strukturuar për studentët.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 17.3: FE pyetësor vlerësimi i lëndës nga studentët</i> <i>Evidenca 17.4: FE pyetësor vlerësimi për pedagogun nga studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës është funksionale dhe ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët. Shërbimet përfshijnë orientimin për zgjedhjen e praktikave profesionale, informimin mbi mundësitë në tregun e punës dhe këshillimin për zgjedhje të rëndësishme akademike. Zyra mirëpret studentët periodikisht, organizon takime dhe ofron burime të dobishme për planifikimin e karrierës. Ky shërbim është një element i rëndësishëm në lidhjen mes studimeve dhe punësimit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 20.3: Studentët Këshillim karriere, FEUT</i></p>

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e karrierës ndjek ecurinë e studentëve pas diplomimit, duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit. Këto të dhëna dokumentohen dhe raportohen për organet drejtuese dhe u vihen në dispozicion studentëve si instrument orientues për të ardhmen. Kjo praktikë kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe në forcimin e lidhjes me tregun e punës. Nga takimi në institucion i GVJ me studentët, stafin dhe përfaqësues të INSTAT, u diskutua se studentët e këtij program studimi vijnë kryesisht nga INSTAT në bazë të marrëveshjeve paraprake me këtë institucion. Në këtë mënyrë ata e kanë të siguar punësimin paraprakisht dhe masteri ju shërben më së shumti për tu ngritur në detyrë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 22.1: Marrëveshjet Ndërinstitucionale</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga analiza rezulton se institucioni ka ngritur një sistem funksional për pritjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve, si dhe për menaxhimin e problematikave që mund të hasin gjatë studimeve. Shërbimet e dedikuara, sistemi i monitorimit të përparimit akademik, zyra e karrierës dhe gjurmimi i studentëve pas diplomimit janë mekanizma që e bëjnë këtë proces të plotë dhe efektiv. Evidencat tregojnë se studentët mbështeten në mënyrë të vazhdueshme, duke përfutur shërbime të dobishme për zhvillimin akademik dhe profesional të tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, në përputhje me fushën e studimeve dhe specifikat e moduleve. Ky udhëzues shërben si instrument orientues për pedagogët në zgjedhjen e metodologjive bashkëkohore, duke nxitur mësimdhënien interaktive dhe të student-qendruar.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.3: Strategjia e zhvillimit e UT 2023-2028</i> <i>Evidenca 1.10: Strategjia institucionale për mësimdhënien 2022-2027</i> <i>Evidenca 1.18: UT Rregullore për funksionimin e komisionit të promovimit akademik</i> <i>Evidenca 5: Plani strategjik i departamentit DSIZ</i> <i>Evidenca 8.7: Trajnimet në FEUT për metodat e reja të mësimdhënies dhe pedagogjinë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë zhvillojnë mekanizma monitorimi dhe kryejnë vlerësime periodike mbi aftësitë mësimdhënëse dhe përdorimin e metodave inovative nga stafi akademik dhe ndihmës. Procesi i monitorimit realizohet në bazë të raporteve të rregullta dhe analizave të performancës së stafit, duke siguruar që mësimdhënien të jetë në përputhje me standardet.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 12.3.1: Plani i veprimtarisë NJSBC 2022-2023</i> <i>Evidenca 12.3.2: Plani i veprimtarisë NJSBC 2023-2024</i> <i>Evidenca 12.3.3: Plani i veprimtarisë NJSBC 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies përmes pyetësorëve, intervistave dhe mekanizmave të feedback-ut. Studentët kanë mundësi të shprehin mendime edhe mbi procesin e vlerësimit të dijeve dhe të paraqesin ankesa, të cilat trajtohen sipas procedurave të përcaktuara. Kjo rrit transparencën dhe përmirëson marrëdhënien pedagog–student.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 12.4: Vendim nr.6 Përberja e Komisionit NJSBC 2024-2025</i> <i>Evidenca 12.6: FE Alumni pyetësor</i></p>

	<p><i>Evidenca 17.3: FE pyetësor vlerësimi i lëndës nga studentët</i></p> <p><i>Evidenca 17.4: FE pyetësor vlerësimi për pedagogun nga studentët</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat e sigurimit të cilësisë bëjnë publike rezultatet e vlerësimeve periodike, duke i shpërndarë ato në nivele të ndryshme të institucionit. Publikimi i rezultateve ndihmon në rritjen e përgjegjësisë së stafit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. Ky transparencë është një element kyç i sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Evidenca 12.3: FE Aktiviteti i NJSBC material përmbledhës</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni përdor rezultatet e vlerësimit për të promovuar praktikat më të mira dhe për të motivuar stafin akademik që të përmirësojë mësimdhënien. Shembujt pozitivë shpërndahen si modele për t'u ndjekur, duke nxitur një kulturë përmirësimi të vazhdueshëm dhe zhvillimi profesional të stafit. Nga takimi me stafin e angazhuar në programin e studimit u shprehen se në këto mekanizma përfshihen trajnimet dhe mobilitetet e stafit në universitete të tjera jashtë vendit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Evidenca 1.21: Rregullore e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 8.5: UT Vendim Senati Plani strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit të UT 23-28.</i></p> <p><i>Evidenca 8.7: Trajnimet në FEUT për metodat e reja të mësimdhënies dhe pedagogjinë</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka ndërtuar një politikë të qartë dhe koherente për garantimin e cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit. Udhëzuesit për metodologjitë e mësimdhënies janë të dokumentuar dhe të harmonizuar me specifikat e fushës, duke nxitur përdorimin e metodave bashkëkohore, interaktive dhe të orientuara drejt studentit. Mekanizmat e monitorimit të brendshëm funksionojnë në mënyrë periodike, duke përfshirë vlerësime të stafit akademik dhe analiza mbi efektivitetin e metodave të përdorura në procesin mësimor. Gjithashtu, studentët janë të përfshirë në mënyrë aktive në vlerësimin e mësimdhënies përmes pyetësorëve dhe mekanizmave të feedback-ut, të cilët ndihmojnë në identifikimin e praktikave të mira dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Publikimi i rezultateve dhe promovimi i praktikave të suksesshme krijojnë një kulturë transparence dhe bashkëpunimi akademik.</i></p>

	<i>Këto elemente tregojnë se sistemi i sigurimit të cilësisë në mësimdhënie është funksional, gjithëpërfshirës dhe i orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Institucioni ka hartuar politika të qarta për sigurimin e brendshëm të cilësisë (SBC), të përfshira në aktet rregullatore institucionale dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. Struktura e posaçme për SBC funksionon në mënyrë të vazhdueshme dhe është përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mbi cilësinë e programeve të studimit.</p> <p>Senati Akademik ka miratuar Manualin e Sigurimit të Cilësisë së bashku me Paketën e Instrumenteve të Cilësisë në ndihmë të procesit të monitorimit, vlerësimi të brendshëm dhe përmirësimit. Fakulteti i Ekonomisë, UT ka krijuar të gjithë bazën e nevojshme për të rritur cilësinë e programeve mësimore dhe për të garantuar vijimësinë e ofrimit të një cilësie mësimdhënieje bashkëkohore.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti UT</i> <i>Evidenca 1.5: UT Manual i Sigurimit të Cilësisë.</i> <i>Evidenca 1.17: FE Udhëzues për sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.21: FE Rregullore e njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidenca 12: Paketa e instrumentave të cilësisë</i> <i>Evidenca 12.4: Vendim nr.6 Përberja e Komisionit NJSBC 2024-2025</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për	Institucioni ka ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, i cili mbështetet në një strategji institucionale për përmirësim të vazhdueshëm. Në këtë proces përfshihen jo vetëm stafi akademik dhe administrativ, por edhe studentët dhe ekspertë të jashtëm, të cilët kontribuojnë me feedback dhe ekspertizë për të rritur cilësinë. Kjo qasje gjithëpërfshirëse

<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>tregon angazhim për standarde të larta akademike. Njësia e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë (NJSBC) është ngritur pranë FEUT dhe ka në përbërje 8 anëtarë, ndër të cilët një student dhe funksionon si mekanizëm për të garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm në FEUT. FEUT ka krijuar Degën e Sigurimit të Cilësisë, si strukturë ndihmës-akademike që punon për zbatimin e politikave mbi cilësinë dhe që mbështet me veprimtarinë e saj KPSSC dhe NJSBC e FEUT.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.17: FE Udhëzues për sigurimit të cilësisë</i> <i>Evidenca 11.1: UT vendim nr.51 Për miratimin e paketës së dokumentatve për sigurimin e cilësisë UT</i> <i>Evidenca 12.3.1/2/3: Plani i veprimtarisë NJSBC 22-23 / 23-24/ 24-25</i> <i>Evidenca 12.4: Vendim nr.6 Përberja e Komisionit NJSBC 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor instrumente dhe tregues të qartë për sigurimin e cilësisë, duke u mbështetur në vlerësime analitike dhe krahasuese. Proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë, si akreditimi dhe vlerësimi periodik, shërbejnë si mekanizma për të garantuar objektivitetin dhe për të promovuar përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit. Evidencat tregojnë se institucionit i është dhënë rëndësi e veçantë integritetit të këtyre mekanizmave në menaxhimin akademik. Një instrument i rëndësishëm monitorimi i jashtëm i cilësisë së mësimdhënies është pjesëmarrja në sondazhin kombëtar të studentëve. UT përfshihet në këtë sondazh, gjetjet e të cilit, konsiderohen për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.3: Strategjia e zhvillimit e UT -2023-2028</i> <i>Evidenca 1.5: UT Manual i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.25: Akreditimi, UT, vendim 27.01.2023</i> https://feut.edu.al/lajmerime/1408-sondazhi-kombetar-i-studenteve-ascal-zhvillon-takim-informues-me-studentet-e-fe https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2025</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm</p>	<p>Për matjen e cilësisë, institucioni përdor tregues të qartë e të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Raportet periodike</p>

<p>në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>evidentojnë arritjet dhe dobësitë e programeve, duke u bërë bazë për hartimin e planeve përmirësuese. Gjithashtu, mbi bazën e këtyre treguesve, institucioni promovon praktikën më të mira dhe motivon stafin akademik për performancë më të lartë. Kjo praktikë lidhet drejtpërdrejt me rritjen e cilësisë së programit dhe me orientimin e tij drejt standardeve ndërkombëtare. Për të mundur një monitorim sistematik dhe krahasues të cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Fakultetin e Ekonomisë miraton periodikisht Planin e Veprimtarisë së saj. Ky dokument përmban një listë të qartë të aktiviteteve që do të monitorohen si dhe të treguesve që do të mblidhen, në përputhje me objektivat e sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 12.3.1 /2 /3: Plani i veprimtarisë NJSBC 22-23 / 23-24 / 24-25</i> <i>Evidenca 21.3.2: Raportim vjetor 2022-2023, DSIZ</i> <i>Evidenca 21.3.3: Raport kërkimi shkencor 2022-2023, DSIZ</i> <i>Evidenca 21.4.1: Raport puna kërkimore shkencore 2023-2024, DSIZ</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shpreh mendimin se institucioni ka ngritur dhe e zbaton në mënyrë efektive sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, i cili bazohet në politika, procedura dhe struktura të dokumentuara qartë në aktet rregullatore institucionale. Ky sistem është ndërtuar në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet e kërkuara nga ASCAL, duke siguruar një qasje të unifikuar për monitorimin e cilësisë në të gjitha fazat e ciklit të studimit. Përmes strategjisë institucionale për përmirësim të vazhdueshëm, janë përcaktuar objektiva të matshëm, indikatorë të performancës dhe mekanizma për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mbi cilësinë akademike dhe kërkimore. Në këtë proces janë përfshirë të gjitha palët e interesuara, stafi akademik e administrativ, studentët, si dhe ekspertë të jashtëm, duke krijuar një sistem të hapur dhe bashkëpunues që mbështet rritjen cilësore të programit të studimit. Përmes vlerësimeve analitike dhe krahasuese, institucioni identifikon arritjet dhe dobësitë, harton plane konkrete për përmirësim dhe promovon praktikën më të mira në mësimdhënie e kërkim. Rezultatet e monitorimit përdoren si bazë për vendimmarrje strategjike dhe për motivimin e stafit akademik në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm. Kjo qasje tregon se sigurimi i cilësisë është një proces i integruar në kulturën</i></p>

	<i>institucionale dhe mbështet përputhjen e programit me standardet kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka mekanizma formalë dhe të dokumentuar për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Këto procese realizohen në mënyrë të rregullt përmes analizave vjetore dhe raporteve të performancës.</p> <p>Vlerësimet përfshijnë identifikimin e arritjeve dhe dobësive, si dhe përcaktimin e masave për përmirësim. Rezultatet i komunikohen strukturave vendimmarrëse të fakultetit dhe universitetit, si Këshilli i Departamentit, Këshilli i Fakultetit dhe Senati Akademik, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe përgatitjes për proceset e akreditimit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullorja e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 1.3: Strategjia e Zhvillimit të UT 2023–2028</i> <i>Evidenca 1.5: Manuali i Sigurimit të Cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme dhe reale të nxënies dhe objektivat formues, të përcaktuara në mënyrë të qartë në dokumentet e programit si syllabuset dhe planet mësimore; Rezultatet reale të arritura, të mbështetura në tregues të matshëm si performanca e studentëve, progresi akademik dhe punësimi pas diplomimit, të pasqyruara në raportet vjetore dhe kërkimore të DSIZ, etj. Gjithashtu këto raporte përfshijnë masat për adresimin e mangësive të evidentuara. Përmes këtij procesi, evidentohen</p>

<p>përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>praktikat më të mira dhe përvojat e suksesshme në mësimdhënie dhe kërkim. Këto raporte shërbejnë si dokumente orientuese për departamentet dhe ndihmojnë në përshtatjen e programeve me zhvillimet shkencore e kërkesat e tregut të punës. Përveç personelit akademik, edhe studentët inkurajohen të kontribuojnë aktivisht në përmirësimin e cilësisë, dhe arritjet e tyre (në punime kërkimore, konferenca studentore apo përfaqësim në struktura vlerësimi) dokumentohen përmes anketimeve studentore dhe pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.3: Strategjia e Zhvillimit të UT 2023–2028</i> <i>Evidenca 1.5: UT Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 2.8: Plane mësimore MSHSZ 22-23-24-25</i> <i>Evidenca 8.2: UT Vendimi nr. 28 Për Grantin në konferenca Shkencore Evidenca 12.3.1/2/3 Plani i veprimtarisë NJSBC 22-23/23-24/24-25</i> <i>Evidenca 17.1/1.2: Raporti i NJSBC 22-23 / 23-24</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për vlerësimin e cilësisë së programit, institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta si analiza të rezultateve të provimeve, vëzhgime në mësimdhënie dhe krahasime me standardet kombëtare. Këto metoda janë të dokumentuara në planet vjetore të veprimtarisë së NJSBC-së dhe shërbejnë si bazë për vendimmarrje mbi përmirësimet në program, si dhe për adresimin e mangësive në nivel kurrikular, metodik apo pedagogjik.</p> <p>Përdorimi i metodave të tilla të drejtpërdrejta reflekton angazhimin e institucionit për të garantuar cilësi të lartë akademike, besueshmëri në proceset e vlerësimit dhe përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Vlerësimi i performancës realizohet në mënyrë të integruar me strukturat e sigurimit të cilësisë dhe i shërben përmirësimit të metodologjive dhe përputhjes me objektivat e të nxënit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 17.3: Pyetësor i vlerësimit të lëndës nga studentët</i> <i>Evidenca 17.4: Pyetësor i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i> <i>Evidenca 21.3.2: DSIZ Raport vjetor 2022–2023</i> <i>Evidenca 21.3.3: DSIZ Raport kërkimor shkencor 2022–2023</i> <i>Evidenca 21.4.1: DSIZ Raport pune kërkimore shkencore 2023–2024</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni përdor edhe metoda të tërthorta për vlerësim, si sondazhet me studentë, alumni, punëdhënës dhe bashkëpunëtorë të jashtëm. Këto të dhëna ndihmojnë në vlerësimin e relevancës së programit dhe përshtatshmërisë së kompetencave që ofron. Përdorimi i feedback-ut nga palët e interesuara ndihmon në krijimin e një panorame të plotë të ndikimit dhe efektivitetit të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 17.5: DSIZ ALUMNI Raport mbi Punësimin-Pyetëtori i FE</i> <i>Evidenca 21.3.2: DSIZ Raportim vjetor 2022–2023</i> <i>Evidenca 21.4.1: DSIZ Raport pune kërkimore shkencore 2023-2024</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shpreh mendimin se proceset e monitorimit dhe vlerësimit të programit janë të rregullta dhe të dokumentuara. Institucioni përdor si mjete vlerësimi të drejtpërdrejta, ashtu edhe të tërthorta, duke siguruar që rezultatet të pasqyrojnë realisht cilësinë e programit. Ky sistem mundëson përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje me zhvillimet akademike dhe tregun e punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin</p>	<p>Institucioni ka mekanizma formale dhe të dokumentuar për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Këto procese realizohen në mënyrë të rregullt përmes analizave vjetore dhe raporteve të performancës. Vlerësimet përfshijnë identifikimin e arritjeve dhe dobësive, si dhe përcaktimin</p>

<p>dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>e masave për përmirësim. Rezultatet i komunikohen strukturave vendimmarrëse të fakultetit dhe universitetit, si Këshilli i Departamentit, Këshilli i Fakultetit dhe Senati Akademik, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe përgatitjes për proceset e akreditimit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullorja e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 1.3: Strategjia e Zhvillimit të UT 2023–2028</i> <i>Evidenca 1.5: Manuali i Sigurimit të Cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme dhe reale të nxënies dhe objektivat formues, të përcaktuara në mënyrë të qartë në dokumentet e programit si syllabuset dhe planet mësimore; Rezultatet reale të arritura, të mbështetura në tregues të matshëm si performanca e studentëve, progresi akademik dhe punësimi pas diplomimit, të pasqyruara në raportet vjetore dhe kërkimore të DSIZ, etj. Gjithashtu këto raporte përfshijnë masat për adresimin e mangësive të evidentuara. Përmes këtij procesi, evidentohen praktikrat më të mira dhe përvojat e suksesshme në mësimdhënie dhe kërkim. Këto raporte shërbejnë si dokumente orientuese për departamentet dhe ndihmojnë në përshtatjen e programeve me zhvillimet shkencore e kërkesat e tregut të punës. Përveç personelit akademik, edhe studentët inkurajohen të kontribuojnë aktivisht në përmirësimin e cilësisë, dhe arritjet e tyre (në punime kërkimore, konferenca studentore apo përfaqësim në struktura vlerësimi) dokumentohen përmes anketimeve studentore dhe pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.3: Strategjia e Zhvillimit të UT 2023–2028</i> <i>Evidenca 1.5: UT Manuali i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullorja për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 2.8: Plane mësimore MSHSZ 22-23-24-25</i></p>

	<p><i>Evidenca 8.2: UT Vendimi nr. 28 Për Grantin në konferenca Shkencore Evidenca 12.3.1/2/3 Plani i veprimtarisë NJSBC 22-23/23-24/24-25</i></p> <p><i>Evidenca 17.1/1.2: Raporti i NJSBC 22-23 / 23-24</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për vlerësimin e cilësisë së programit, institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta si analiza të rezultateve të provimeve, vëzhgime në mësimdhënie dhe krahasime me standardet kombëtare. Këto metoda janë të dokumentuara në planet vjetore të veprimtarisë së NJSBC-së dhe shërbejnë si bazë për vendimmarrje mbi përmirësimet në program, si dhe për adresimin e mangësive në nivel kurrikular, metodik apo pedagogjik.</p> <p>Përdorimi i metodave të tilla të drejtpërdrejta reflekton angazhimin e institucionit për të garantuar cilësi të lartë akademike, besueshmëri në proceset e vlerësimit dhe përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Vlerësimi i performancës realizohet në mënyrë të integruar me strukturat e sigurimit të cilësisë dhe i shërben përmirësimit të metodologjive dhe përputhjes me objektivat e të nxënit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Evidenca 17.3: Pyetësor i vlerësimit të lëndës nga studentët</i></p> <p><i>Evidenca 17.4: Pyetësor i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i></p> <p><i>Evidenca 21.3.2: DSIZ Raport vjetor 2022–2023</i></p> <p><i>Evidenca 21.3.3: DSIZ Raport kërkimor shkencor 2022–2023</i></p> <p><i>Evidenca 21.4.1: DSIZ Raport pune kërkimore shkencore 2023–2024</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe</p>	<p>Institucioni përdor edhe metoda të tërthorta për vlerësim, si sondazhet me studentë, alumni, punëdhënës dhe bashkëpunëtorë të jashtëm. Këto të dhëna ndihmojnë në vlerësimin e relevancës së programit dhe përshtatshmërisë së kompetencave që ofron.</p> <p>Përdorimi i feedback-ut nga palët e interesuara ndihmon në krijimin e një panorame të plotë të ndikimit dhe efektivitetit të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Evidenca 17.5: DSIZ ALUMNI Raport mbi Punësimin - Pyetësori i FE</i></p> <p><i>Evidenca 21.3.2: DSIZ Raportim vjetor 2022–2023</i></p> <p><i>Evidenca 21.4.1: DSIZ Raport pune kërkimore shkencore 2023–2024</i></p>

palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.									
Konkluzione	<i>GVJ shpreh mendimin se proceset e monitorimit dhe vlerësimit të programit janë të rregullta dhe të dokumentuara. Institucioni përdor si mjete vlerësimi të drejtpërdrejta, ashtu edhe të tërthorta, duke siguruar që rezultatet të pasqyrojnë realisht cilësinë e programit. Ky sistem mundëson përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje me zhvillimet akademike dhe tregun e punës.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Politikat institucionale garantojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve në proceset e sigurimit të cilësisë. Në këtë kuadër, janë të përcaktuara mënyrat e pjesëmarrjes së departamenteve, stafit akademik, studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm.</p> <p>Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron që proceset e vlerësimit të mos jenë formale, por të përqendrohen në përmirësimin real të cilësisë së programeve.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, neni 141</i> <i>Evidenca 1.21: FEUT-Rregullore për sigurimin e cilesie NJSBC, neni 6</i> <i>Evidenca 17.2: Strategji, Plan veprimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë 21-24 në UT</i></p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të	Institucioni përcakton qartë përgjegjësitë për secilën njësi në procesin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron zbatimin e tyre. Raportet e brendshme reflektojnë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas niveleve organizative. Në nivel institucional përgjegjësit për cilësinë janë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komisioni i përhershëm i Cilësisë së UT, Rektori,

<p>cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Administratori i UT, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti, Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, Këshilli i Studentëve. Detyrat, individët, strukturat janë të përcaktuara në rregulloren për sigurimin e cilësisë, përfshirja e studenteve shprehen qartësisht në statutin dhe rregulloren e UT. Kjo strukturë funksionale garanton ushtrimin me përgjegjësi të detyrave dhe transparencë në raportimin e rezultateve.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.2: Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.5: UT, Manual i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin e programeve ndodh përmes anketave, takimeve dhe konsultimeve të rregullta. Këto mekanizma mundësojnë një komunikim të drejtpërdrejtë midis palëve dhe ndihmojnë në adresimin e problematikave në kohë. Kjo formë bashkëpunimi ndikon pozitivisht në përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe përmbajtjes së programeve. Nga evidencat por edhe nga takimet në institucion, GVJ konstaton se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit janë të përfshirë edhe pedagogët dhe studentët, të cilët me anë të mendimeve, sugjerimeve apo nevojave të tyre, që jepen me anë të anketimeve por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.5: UT, Manual i Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore e NJSBC</i> <i>Evidenca 17.3: FE pyetësor vlerësimi i lëndës nga studentët</i> <i>Evidenca 17.4: FE pyetësor vlerësimi për pedagogun nga studentët</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Proceset e përfshirjes së aktorëve respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo formë pabarazie. Studentët dhe stafi trajtohen si partnerë në procesin e përmirësimit të cilësisë. Struktura e NJSBC ngrihet sipas Statutit të UT (Neni 141) [Ev.1.1]. Përbërja e tyre përcaktohet nga vetë njësitë kryesore duke përfshirë edhe përfaqësues të studentëve. Përzgjedhja e personave kryhet në integritet të plotë dhe transparent. Kjo nxit një kulturë bashkëpunimi dhe besimi të ndërsjellë ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve në sistemin arsimor.</p>

	<p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.4: Kodi i Etikës UT</i> <i>Evidenca 1.6: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 8.4: Barazia Gjinore PBGJ 2022-2024</i> <i>Evidenca 8.4.1: Barazia Gjinore PBGJ 2024-2026</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në vlerësimin e programeve përfshihen edhe ekspertë të jashtëm, të cilët ofrojnë perspektiva objektive dhe profesionale mbi cilësinë dhe përmirësimin e mëtejshëm. Specifikisht në këtë program studimi është shfrytëzuar marrëveshja me INSTAT, ku disa prej specialistëve më të mirë të këtij institucioni janë aktivizuar si pedagogë të ftuar, por nga ana tjetër, shumica e studentëve që kanë përfunduar masterin ose janë në process, janë punonjës të INSTAT. Por janë edhe shumë institucione të tjera, marrëveshjet me të cilat krijojnë mundësi për të gjithë studentët në Fakultetin e Ekonomisë për të zhvilluar leksione të hapura nga specialist të ndryshëm, praktika mësimore për studentët, intershipte, apo edhe punësim. Kjo praktikë ndihmon në përafrimin e standardeve institucionale me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe forcon besueshmërinë e sistemit të cilësisë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Evidenca 22.1: Marrëveshjet Ndërinstitucionale</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon se përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në proceset e sigurimit të cilësisë është reale dhe efektive. Institucioni ka krijuar një kulturë bashkëpunimi që nxit përgjegjësinë, transparencën dhe integritetin akademik në çdo fazë të vlerësimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Statistika Zyrtare” ofruar nga Universiteti i Tiranës

Pikat e forta dhe afirmime

1. Strukturë akademike solide dhe staf i kualifikuar. Programi mbulohet kryesisht nga staf i brendshëm me përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe me formim të thelluar në fushën e statistikës dhe ekonomisë.
2. Përputhje e plotë me nevojat e tregut të punës. Programi është konceptuar në bashkëpunim me institucione publike e statistikore (INSTAT, ministri linjë), duke siguruar një profil profesional të kërkuar në tregun shqiptar dhe rajonal.
3. Sistem funksional i sigurimit të cilësisë. Mekanizmat për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë janë të institucionalizuar, të dokumentuar dhe të përfshirë në cikle të rregullta analitike.
4. Përfshirje aktive e studentëve. Studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse dhe këshilluese, marrin pjesë në pyetësorë dhe në takime konsultative, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e programit.
5. Infrastrukturë e përshtatshme dhe mbështetje administrative. Fakulteti ofron mjedise moderne, laboratorë kompjuterikë dhe shërbime efikase për mbështetjen akademike dhe teknike të studentëve.
6. Lidhje e ngushtë me tregun e punës. Programi përfshin module aplikative, praktika profesionale dhe bashkëpunime me institucione statistikore që ndihmojnë punësimin e studentëve pas diplomimit.

Pika të dobëta

1. Personeli akademik të përditësojë literaturën në syllabuset e lëndëve, duke përfshirë më shumë botime të publikuara në pesë vitet e fundit. (Standardi II.4 kriteri 5)

Rekomandime

1. Integrimi i metodave të inteligjencës artificiale dhe analitikës së avancuar në kurrikul do ta bëjë programin më konkurrues. (Standardi I.2 kriteri 2)
2. Përshtatja e emërimit të programit dhe me Data Science, do e bënte programin më atraktiv për studentet. (Standardi I.1 kriteri 4)
3. Rekomandohet që praktikat profesionale mos jenë të fokusuara vetëm në institucione publike si INSTAT etj por të shtrihen me gjerë edhe në ato jo publike. (Standardi III.4 kriteri 1)



4. Rekomandohet që trendi pozitiv i rritjes së stafit të vijojë në mënyrë të qëndrueshme edhe në vitet e ardhshme, duke synuar përforcimin e mëtejshëm të kapaciteteve akademike dhe kërkimore të programit. **(Standardi III.1 kriteri 4)**

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in
"Official Statistics" provided by the University of Tirana**

Strengths and affirmations

1. Solid academic structure and qualified staff. The program is primarily delivered by internal academic staff with extensive experience in teaching and scientific research, as well as with advanced qualifications in statistics and economics.
2. Full alignment with labor market needs. The program has been designed in collaboration with public and statistical institutions (INSTAT, line ministries), ensuring a professional profile that is highly demanded in the Albanian and regional labor markets.
3. Functional quality assurance system. Mechanisms for monitoring, evaluating, and improving quality are institutionalized, well-documented, and embedded in regular analytical review cycles.
4. Active student involvement. Students participate in decision-making and advisory bodies, respond to surveys, and engage in consultative meetings, directly contributing to the continuous improvement of the program.
5. Adequate infrastructure and administrative support. The faculty provides modern facilities, computer laboratories, and efficient academic and technical support services for students.
6. Strong connection with the labor market. The program includes applied modules, professional internships, and collaborations with statistical institutions that facilitate student employment after graduation.

Weaknesses

1. Academic staff to update the literature in the course syllabi, including more publications published in the last five years. **(Standard II.4 criterion 5)**



Recommendation

1. Integration of artificial intelligence and advanced analytics methods into the curriculum would make the program more competitive. **(Standard I.2 criterion 2)**
2. Adjusting the program title to include “Data Science” would enhance its attractiveness to prospective students. **(Standard I.1 criterion 4)**
3. It is recommended that professional practices not be focused only on public institutions such as INSTAT, etc., but be extended more widely to non-public ones as well. **(Standard III.4 criterion 1)**
4. It is recommended that the positive trend of staff growth continue in a sustainable manner in the coming years, aiming to further strengthen the academic and research capacities of the program. **(Standard III.1 criterion 4)**



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

